| Numri i lëndës / Broj Predmet/Case Reference Number: | 07-941-17902/2017 |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 14.04.2017- 8:24 |
| Komuna / Opština / Municipality: | Gllogoc/Glogovac/Gllogoc |
| Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | DOMANEK/DOMANEK/DOMANEK |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | Gllogoc/Glogovac/Gllogoc |

Drejtori/Direktor/Director

Referenti/Referent/Referent

### A. TE DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI/CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. unit No. | Lloji i njësise<br>Vrsta jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona-<br>U/R<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>m2 | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Urađeno na dan<br>Created on | Azhurnuar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-70315024-00258-1 | PARCELË/PARCELA/<br>PARCEL | Pronë shoqerore/Drushtvena Imovina/Socially owned Land | U | 2500 | | 14.04.2017 | 14.04.2017 |

### A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Zvano mesto<br>Place name | Kodi postal<br>Poštanski fah<br>PostalCode | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address Details | Krijuar më datën<br>Urađeno na dan<br>Created on | Azhurnuar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| ARA POSHT-RRUGA/ARA POSHT-RRUGA/ARA POSHT-RRUGA | - | // | 14.04.2017 | 14.04.2017 |

### A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORIŠĆENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta korišćenja parcele<br>Parcel type of use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno korišćenje parcele<br>Parcel current use | Klasa e kualitetit<br>Klasa kvaliteta<br>QualityClass | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>(m2) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Kullosat/Pašnjaci/pasture | Kullosë E Klasës I/Pasnjak 1 Klase/1st Class Pasture | 2500 |

### B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Lični broj<br>ID. no. | Vendbanimi<br>Prebivalište<br>Residence | Kodi postal<br>Poštanski fah<br>PostalCode | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address Details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Përshkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual/Individualna Drzavina/single possessor | PASURI SHOQËRORE E K.K.GLLOGOVC | KCID0304670 | DOMANEK/DOMANEK / DAMANEK | - | Rruga /Ulica /STREET GLLOGOVC | 1/1 | | 14.04.2017 |

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : GLLOGOVC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Domanek

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m2 |
|---|---|---|
| P-70315024-00258-1 | Pracelë / Parcela / Parcel | 2500,0 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:1000

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 14.04.2017

Koha/ Vreme/ Time: 08:41:40

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: MCO GLLOGOVC director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

REPUBLIKA E KOSOVËS · KOMUNA GLLOGOC · REPUBLIC OF KOSOVA · GLLOGOC MUNICIPALITY

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit(Gllogocit)
Kuvendi i Komunës

12 Nr.400-23504 dt 10.05.2017

Duke u bazuar 11,12 dhe 40 të Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji për Sport i Kosovës dhe bazuar në rekomandimin e Njësisë së Sportit për nevojën e rregullimit të funksionimit të Stadiumit Sintetik në Drenas,nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më dt:03.05.2017 miratoj këtë:

# RREGULLORE
# për
# Stadiumin „Rexhep Rexhepi" dhe Stadiumin Sintetik të Drenasit

## Neni 1 – Qëllimi

a. Rregullorja për Menaxhimin e **Stadiumit „Rexhep Rexhepi" dhe Stadiumit Sintetik në Drenas** (këtu e tutje „Rregullorja") ka për qëllim përcaktimin dhe definimin e pronësisë, menaxhmentit, organizimit të brendshëm, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe aktiviteteve që zhvillohen në Stadiumin „Reshep Rexhepi" dhe Stadiumin Sintetik të Drenasit (këtu e tutje SRRSSD)

## Neni 2- Përkufizimet

Shkurtesat që përdoren në këtë rregullore kanë kuptimin e vetë të cilat shpjegohen në vijim:

a. SS- Nënkupton Sektorin e Sportit që është pjesë e ekzekutivit të komunës së Drenasit dhe është kompetente për organizmin e jetës sportive në komunën e Drenasit.
b. SRRdhe SSD- Nënkupton objektin e Stadiumit Sintetik të Drenasit, ku përfshihet objekti si dhe fusha sportive.
c. Koordinatori i SRR dhe SSD – është zyrtari i komunës respektivisht Sektori i Sportit, i cili përkujdeset për objektin e stadiumit Sintetik të Drenasit dhe koordinimin e klubeve, shkollave dhe individëve që frekuentojnë në këtë hapësirë sportive.

## Neni 3 – Emri dhe simbolet.

a. Objektet e Stadiumit dhe fushave në këtë rregullore quhen: Stadiumi „Rexhep Rexhepi " dhe Stadiumi Sintetik i Drenasit me shkurtesë SRR dhe SSD.

**Neni 4- Fushëveprimi i Rregullores**

a. Kjo Rregullore është e vlefshme vetëm për objektet e Stadiumit ,,Rexhep Rexhepi" dhe Stadiumit Sintetik të Drenasit, për strukturat administrative të saj si dhe për aktivitetet që zhvillohen në te.

**Neni 5- Objekti i Stadiumit ,,Rexhep Rexhepi" dhe Stadiumit Sintetik në Drenas**

a. Objektet e SRR dhe SSD janë pronë e komunës së Drenasit dhe komuna e Drenasit është organ i vetëm kompetent që vendos për to.
b. Objekti e SRR ndodhen në rrugën,, Martirët e Paklekut" dhe SSD ndodhet në rrugën Shaban Palluzha,është ndërtesë një katëshe si dhe posedon fushën me bari sintetik.
c. Objekti ka gjithësejt 6 zhveshtore, 3 zyre pune dhe ka një sallë që sherben për aktivitete sportive si dhe një lokal për byfe.

**Neni 6- Struktura Organizative**

a. SRR dhe SSD janë asete të komunës së Drenasit, nën administrimin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport gjegjësisht Sektorit të Sportit dhe janë pjesë strukturore dhe organizative e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
b. Vendim marrja për aktivitetet që zhvillohen në SRR dhe SSD përcaktohen me rregullore të brendshme dhe përmes marveshjes me Sektorin e Sportit.

**Neni 7- Aktivitetet që zhvillohen në SSD**

a. Në SRR dhe SSD mund të zhvillohen aktivitete të cilat kanë karakter garues, edukativ, promovues dhe sportive.
b. Në SRR dhe SSD nuk mund të zhvillohen aktivitetet që bien ndesh me Ligjin dhe Rregulloret që mbrojnë sportistët nga fenomenet negative.

---

**Neni 8- Rregullimi dhe ndryshimi i hapësirave të SRR dhe SSD**

a. Investimet në SRR dhe SSD bëhen vetëm me miratimin dhe vendimin e Kryetarit të komunës.
b. Ndryshimet e vogla të hapësiarave në SRR dhe SSD të cilat nuk dëmtojnë objektin, imazhin apo pasurinë e saj bëhet me pëlqimin e udhëheqësit të Sektorit të Sportit dhe Menaxhmentit të komunës.

**Neni 9- Mirëmbajtja e SSD**

a. Komuna e Drenasit përmes Sektorit të Sportit kujdeset për investimet, mirëmbajtjen fizike dhe pastërtin e objektit nëpër mjet koordinatorit të SRR dhe SSD.
b. Koordinatori i SRR dhe SSD-së ngarkon me përgjegjësi të gjithë shfrytëzuesit e SRR dhe SSD-së me anë të një marrëveshje të mirëkuptimit.

**Neni 10- Financat**

a. SRR për një ndeshje sportive 90 min. ....................250€
b. SRR për ushtrime 90 min.......................................150€
c. SSD inkason të hyra nga shkollat e regjistruara të futbollit:
   - Fatos-kadet për 60 min...........30€.
   - Për junior për 60 min..............60€
   - Ndeshje sportive 90 min........150€
d. Inkasimi i mjeteve bëhet sipas rregullores për taksa dhe tarifa të komunës së Drenasit.
e. Mjetet e inkasuara arkëtohen në zyren e financave pran Sektorit.
f. Për të gjitha mjetet e inkasuara nga aktivitetet e ndryshme në Stadiumin „Rexhep Rexhepi" dhe Stadiumin Sintetik të Drenasit Kryetari i komunës do të njohtohet me raporte të njëpasnjëshme dhe në mënyrë periodike.
g. Nga tarifat e përcaktuara në pikën a), b) dhe c) të nenit 10. janë të liruara nga pagesa të gjitha klubet të cilat veprojnë në komunën e Drenasit, me përparësi në shfrytëzim të SRR dhe SSD nga klubet publike të Drenasit.

**Neni 11- Dispozitat kalimtare**

Kjo rregullore hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Naim Bazaj

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**Komuna e Drenasit (Gllogocit)**
Kuvendi i Komunës
12 Nr. 463-25503 dt.10.05 2017

Në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit nr. 03/L- 040 për Vetëqeverisje Lokale , nenit 10 të Ligjit Nr. 04/L-144 për dhënjen në shfrytezim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit , Kuvendi i Komunës të Drenasit në mbledhjen e rregullt të mbajtur me dt. 03.05.2017 miratoj këtë:

VENDIM

Neni 1

Për dhënje në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës komunale të Komunës së Drenasit për ndertimin e objektit për punë Administrative (zyreve) dhe objekteve tjera ndihmëse të Kompanisë rajonale të ujësjellsit "Prishtina"sh.a. NJOU në Drenas në teritorin e Komunës së Drenasit,caktohet lokacioni ngastra kadastrale nr.326/3 në siperfaqe prej S=0.15.00ha në vendin e quajtur "Fshat-ledinë"zona kadastrale Qikatova e Re Komuna e Drenasit.

Neni 2

Obligohët parashtruesi i kerkesës që me kerkesë në Drejtoratin për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës se Drenasit të siguroj dokumentacionin zyrtar-valid për ndertimin e objekteve si lejën e ndërtimit dhe kushtet tekniko-urbanistike për lokacionin e destinuar për ndërtim të ketyre objekteve për nevojat e Njësisë operative të ujësjellësit në Drenas

Neni 3

Më këtë vendim Obligohët Drejtorati për Kadastër ,Gjeodezi dhe Pronë që të benë bartjën Administrative që këtë sipërfaqeje toksore në emer të shfrytezuesit të objekteve të KRU"Prishtina"NJOU në Drenas dhe të benë regjistrimin në RDPP.

Neni 4

Me këtë vendim do të njoftohen :Drejtoratet e Komunës së Drenasit.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e Miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlersimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Naim Bazaj

Republika e Kosovës
Komuna Gllogoc

Komisioni Komunal
për Komosacion
Nr. 952/11197
Dt: 02.05. 2017

Zona Kadastrale : Çikatova e Re

Aktvendimi nr.
Data e leshuarjes:

# EKSTRAKT
## NGA FLETËTREGUESI I TOKËS NË MASËN KOMOSATIVE

Pronari: Pasuri Komunale- Drenas    Vendbanimi: Drenas

| Ngastra | Plani | Tabela | "Vendi i quajtur" | Kultura | Klasa | Sipërfaqja Ha | ar | m | | Viti |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 326-3 | | | FSHAT -LEDINË | | | 0 | 15 | 00 | | |

Gjithsejt: 0 | 15 | 00

Referent

Drejtor

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : GLLOGOVC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Çikatova e Re

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi / vrsta / Type | Siperfaqja/Povrsina/Area |
|---|---|---|
| 00326-3 | parcelë/parcela/parcel | 1500,0 |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |




Shkalla/Razmera/Scale : 1000

Punoi/ Obradio/ Created:
Data/ Data/ Date: 02.05.2017
Koha/ Vreme/ Time
Nënshkrimi/Potpis/Signature
Shenime/Beleske/Note:

Aprovoi /Usvojio/Aproved : MCO GLLOGOVC directo
Nënshkrimi /Potpis/Signature

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT

KUVENDI I KOMUNES

12 Nr. 031/01-25550 dt. 10.05. 2017

# Mbledhja e rregullt
# Kuvendi Komunal
# 29.03.2017

**PROCESVERBAL**
**I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më dt.29.03.2017**

**Mbledhjen e kryesoi NAIM BAZAJ – Kryesues**

**Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të rregullt të Kuvendit Komunal ku të pranishëm ishin 31 anëtarë**

Kuvendi filloi punimet më këtë :

## Rend dite:

1. Proces verbali i mbledhjes të dt.27.02.2017
2. Raporti i punës Janar-Dhjetor 2016 i Kryetarit të Komunës
3. Raporti vjetor i buxhetit për vitin 2016
4. Propozim vendim për bartjen e të hyrave vetanake
5. Propozim-Rregullore për kushtet,kriteret dhe procedurat e ndarjes së Subvencioneve
6. Propozim vendim për mbeshtetje më mjete financiare Qendrën për Rehabilitim "Handikos" –dega në Drenas
7. Propozim-Rregullore për organizimin e punës në institucionet edukative-arsimore në Komunën e Drenasit
8. Propozim vendim për financimin e projektit KH„Drenica" (M)
9. Propozim vendim për financimin e projektit FC„Feniksi"
10. Propozim vendim për financimin e projektit KV „Gryka" (F)
11. Propozim vendim për financimin e projektit SHKA „Shotë Galica"
12. Propozim vendim për financimin e projektit KV„ Drenasi " (F)
13. Propozim vendim për financimin e projektit KF„ Gryka"
14. Propozim vendim për financimin e projektit Klubi i Boksit „Drenasi"
15. Propozim vendim për financimin e projektit KH „Drenica" (F)

16. Propozim vendim për financimin e projektit KF"Feronikeli"
17. Propozim vendim për financimin e projektit KV,,Drenasi"(M)
18. Propozim – Rregullore për përcaktimin e kritereve dhe procedurës për dhënien me qira të banesave në pronësi të Komunës
19. Raportet e Komiteteve Konsultative
   a)Raporti i Komiteti Konsultativ për Arsim,Kulturë,Rini e Sport
   b)Raporti i Komiteti Konsultativ për Zhvillim Ekonomik.Mbrojtje të Ambientit
   Shëndetësi dhe Mirqënje Social
20. Plotësimi dhe zevendsimi me një antarë të K.P.F-ca

***Prezentuan:Kryetari i Komunes z.Ramiz Lladrovci ,perfaqësues te KFOR-it, perfaqësues të OSCE-së dhe perfaqësues të mediave***

Takimi filloi punimet në ora 10:15

**NAIM BAZAJ** - Shpalli te hapura punimet e kesaj mbledhje i cili i njoftoj te pranishmit me rendin e dites ,dhe kerkoj nga të pranishmit se a pajtohen më këtë rend dite,por në këtë rast i njoftoj që nga rendi i dites hiqet pika 7
**NAIM BAZAJ**- hodhi në votim që pika e 7 të hiqet nga rendi i dites
Me rastin e votimit prezent ishin 27 anëtarë
Rezultati i votimit ishte si vijon:
Për:26
Kundër:01
Abstenim:0
**VEHBI BERISHA** -kerkoj që raporti i punes të kryetarit të shtyhet per mbledhjen e radhes pasi që nuk kemi pasë mundsi ta shqyrtojmë
**ISTREF EKSHANI** –a është harru apo pse nuk e kemi propozimin per financimin e klubit te futbollit "Feronikeli"
**NAIM BAZAJ**- hodhi në votim rendin e dites,me dy pika shtesë
1.Plani i punës se Kuvendit të Komunës si dhe
2.Propozim vendimi për financimin e këshillit Lokal të Veprimit Rinor
Me rastin e votimit prezent ishin 26 anëtarë
Rezultati i votimit ishte si vijon:
Për:26
Kundër:0
Abstenim:0
**NAIM BAZAJ**- hapi diskutimin për piken e parë të rendit të dites
**1.Proces verbali i mbledhjes të dt.27.02.2017**
**RIFAT BILALLI**-nuk e pata ndermedend të dal por pasi që në mbledhje e kaluar e pata nje konflikt me Kryetarin dhe pas disa intervistave të dhëna në tv (media)nga kryetari,kryetari ka gabu edhe një herë, tash po luan edhe rolin e psikiatrit dhe uroj këtë kuvend në kemi edhe nje psikiatër ketu, unë jamë i plagosur më 5 plumba ,jam edhe familje e deshmorit, thot se unë jamë i traumatizuar nga lufta,por unë edhe në ditet e para pas lufte jo qe kamë qen i traumatizuar por kamë qene shumë stoik dhe shumë i fort, por sot jamë i traumatizuar kur i shoh këta që qeverisin sot,por ju qytetar të drenasit ju vlersoni sot se kush është i traumatizuar ,une kamë qen i traumatizun dhe kamë më mbet i traumatizum gjithmonë se gjerat e verteta i them kush do që është ,kështu kamë pas qendrim edhe para luftës edhe kur janë ber ndryshimet

kushtetuese une i kamë kundeshtu ato ndryshime, kur disa prej kolegeve te mi rrehnin shuplake, sepse kame thenë se keto janë vendime staliniste, ashtu e kamë lindjen,por sot une e ndjej fyemje shum të rend kur nje kryetar komune, qohet dhe thot se ky është i traumatizuar nga lufta une as skam qene i traumatizuar, e as nuk jame,të traumatizuar janë ata që me quajn mu keshtu ata i ka traumatizu e mira,i ka traumatizu paraja e qytetarve të kosovës .
Unë kerkoj që i gjithë fjalimi i mbledhjes se kaluar të regjistrohet në proces
**SOKOL BYLYKBASHI**-pati vrejtje në proces se nuk është regjistruar fjalimi i im tek emertimet kamë fol rreth pesë minuta a është shkruar vetëm një rresht
**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI** -pati vrejtje se unë kamë thënë segmentet e rrugëve nuk mund të këputen dhe të vendosen dy apo tre emra e jo rrugë të drejta,ndersa sa i perket fjalimit të Rifat Bilallit iu pergjigjë,une kamë shum respekt mesuesi rifat për ty për familjet e deshmorve, dhe për të gjithë ata që kanë kontribu,e ke nisur për hajgare dhe unë këtu të kamë kerku falje publike, por ti nuk je i traumatizuar prej luftës, por je i traumatizuar prej vitev 80 si mësues kur ke qene dhe ti e dine në bashkëpunim me zotrin Halit Krasniqin, mësuesin nga Gllanasella keni punuar bashk, dhe traumat i keni marrë pasi që nxënëset e juaja kanë tentu të bejnë vrasje dhe kanë pi helëm, traumat i ke prej atëher nuk i ke prej tash prandaj nuk tërhiqem prej asaj që je i traumatizuar dhe më trauma po shihesh edhe gjatë sjelljes, kështu që për ato që i kemi folë në asamble dhe kur është kthy ne seriozitet të kamë kerku falje ,por tash po thëmë që je i traumatizuar pas vitev 80-ta si mesues kur ke punuar dihen publikisht dy nxënese që kanë pi helem kanë dasht me bëre vetvrasje dhe ju e dini mir arsyen pse ato kanë dasht më bere vetvrasje
**RIFAT BILALLI**- uroj edhe njeher që je psikiater i mirë dhe punon më keto gjana, ti thuaj fjale sa të duash, populli e di kush jamë unë, e që ketu mbrenda kame edhe nxënëse të mijat e dinë shum mirë, se kush ka qene Bilalli, kur në shkollë sulmohet shkolla nga nje person që spo ja permendi emrin e që eshtë nga Baica që e ka vrare UÇK-ja, kur vinë edhe i sulmojn nxenesit, dhe kush u doli ne mbrojtje atyre, e dinë të gjithë kush ,por ty të konvenon me u marr më ato gjana por nuk është e vertet ajo ,dhe une jo që jamë i traumatizuar por jame 100 her më mir se ti se ty të kanë traumatizu paret dhe fondi Vendlindja Thirret, dhe nuk e di derikur ke më shku keshtu, dhe ajo pasuri që ju e keni bërë pa ndjersen e popullit ju ka quar pesh, dhe një dite keni me u qu pesh dhe keni me pasë pasoja shumë të renda ,por të kisha thënë terhiqu nga ato dhe rri, se edhe une kamë respekt dhe për shkak të respektit për Fehmiun që e kamë njoft më parë dhe bacit tush, ty shum von të kam njoft dhe të kamë konsideruar si familje me respekt në bazë të Fehmiut edhe Tushit kamë pas respekt ,edhe e din edhe keta kolegt ketu kur ka qene rasti per sheshin qysh jame sjell une rreth asaj figure, por nuk sjellem për shkak tëndin por për shkak të atij dhe do të sjellem qdo her pa marrë paraysh qysh vjen puna me ty, edhe rrehemi edhe vrahemi une prap kame me qene per Fehmiu edhe për gjith deshmoret i njejti, kam me u perul deri në fune te kembeve ndaj atyre ,por jo ndaj injorantëve dhe armiqeve jo kurr as nuk kam më dit se kush janë,as syri nuk kamë më mu trem ,më pas dit sot i kisha marre tre plumbat që i kamë nxjerr nga trupi dhe ti kisha pru ketu dhe më të pyet se cili kishe pas qef me me rroke në ball ,por me vjen keq prej qytetarve që e kanë votu nje kryetar të till ne vend që të jet një kryetar i unitetit ,ty po ta merr mendja që je bere një diktator sikur që ishte Enver Hoxha ,edhe unë e kame dasht Enver Hoxhen por tash e shoh se idet e tina kanë qen diktatoriale dhe ty sot tu kanë ngulitur këto

ide ,dhe dëshiron në qdo form me i diskreditu qdo kend pamarrë parasysh kush është.

**SABRIJE KUKAJ**-është shumë e ultë me etiketu njerzë, me etiketu njeri tjetrin,se edhe ne KPF-ca kryetari e ke folur këtë qeshtje por e ka thënë edhe një, se une e di nje person se kush ka qene bashkepuntor i Hamzes dhe Ajetit ma mirë është të merremi me punë se sa me thashë e theme

**NAIM BAZAJ**- hodhi në votim këtë pikë të rendit të dites më ndryshime

Me rastin e votimit prezent ishin 28 anëtarë

Rezultati i votimit ishtë si vijon:

Për:28

Kundër:0

Abstenim:0

**NAIM BAZAJ**- hapi diskutimin për piken e dytë të rendit të dites

**2.Raporti i punës Janar-Dhjetor 2016 i Kryetarit të Komunës**

**ARSIM HAXHIU**-i pershendeti të pranishmit dha një aesyetim të shkurter rreth raportit të punës se kryetarit për vitin 2016 ,dhe i njoftoj anëtaret e kuvendit se ky raport është i pergaditur nga secila drejtori dhe i permbledhur në tansi është mjaft voluminoz por besoj se edhe ju e keni shqyrtuar dhe pres nga ju që te japni sygjerimet dhe rekomandimet e juaja e ne do ti marrim per bazë dhe nese kaindonjë pyetje do tju pergjigjemi.

**VEHBI BERISHA**-unë qysh në fillilm kerkova që ky raport të shtyhet per mbledhjen e radhes per shkak se ka një material bukur të madh per ta shqyrtuar,por për raportin e radhes kisha kerku që në raport të kemi te pasqyruar në menyrë tabelare listen e projekteve kapitale ,se qka është perfunduar e qka jo,dhe të ndrrohet kjo forme e raportit.

**SOKOL BYLYKBASHI**-qeverisja e komunës se Drenasit është më teper në sherbim të individve se sa në sherbim të qytetarëve,gjatë kësaj periudhe ka pasur shumë shkelje,shumë padrejtësi.

Vrejtje:te zyra e kryetarit ka pasë kerkesa në nr1330a janë zgjedhë keto kerkesa dhe sa prej tyre janë marrë për bazë

Zyra e informimit-është zyra që ka bërë punen më të mirë sipas mendimit tim ,pastaj kemi zyren e auditorit të brendshem që për herë të parë paraqitet në këtë raport, por shumë shkurt thuhet se gjatë vitit gjithësejt ka pasë 57 rekomandime, të zbatuehsme 25,pjesërisht të zbatueshme 15 dhe 17 rekomandime të pazbatuara,ketu ne është dashur ta dimë se cilat janë rekomandimet e pazbatuara.

Zyra e informimit-thuhet se mungon stafi per qdo vitë është i njejti problem unë besoj se kryetari i ri e plotëson stafin dhe ne të ardhmen nuk do ta kemi këtë problem.

Drejtoria e urbanizmit-kjo drejtori nuk na ka dergu një raport apo një listë te projekteve kapitale se cilat projekte kanë perfundu e cilat jo,dhe herave tjera është mirë me pasë këtë listë,pastaj thuhet se ka mungesë të stafit në këtë drejtori si dhe per mbikqyrje të projekteve ka mungesë të veturave,në këtë rast unë kisha kerku që gjatë vikendeve organi mbikqyres i projekteve të jetë në teren se firmat punen më se shumti e kryejnë gjatë ketyre ditëve kur nuk ka kush i kontrollon.

Drejtoiria e arsimit-pati pyetje se si janë shpenzu dhe ku janë marrë 7.000mijë euro para fillimit të fushates per zgjedhje të kryetarit të komunës,që është mbajtë një darkë me mësimdhenes nga kryetari i shtetit ,ku është një vlerë

shumë e madhe dhe me keto mjete shumë ma mirë ka qenë me ndihmu ndonjë familje skamnore qe ne kemi mjaft këso familjesh se me i shpenzu per fushat. Drejtoria e sherbimeve publike-ka qenë sfidues muaji shkurt dhe mars thuhet në raport,asgjë nuk kanë bërë kudo ka deponi dhe askush nuk kujdeset për këtë edhe në treg mu vetë me ka ndodhë ku ka pasë shumë mbeturina e edhe janë djegë ato mbeturinë në treg ,qka ka ndiku ne mjedisë,pastaj në mirëmbajtjen e sheshit askush nuk kujdeset,nuk ka drita,nuk ka ujë pse nuk perdoren masa ndeshkuese nese dikush e kryen vepren.

**FLORENTINA ELEZI**-Unë e di se shkollat kanë një marrëveshje te nenshkruar me feronikelin per dergimin e nxënësve në praktik atje ,pse nuk po zbatohet kjo marrëveshje dhe asnjëherë nxënësit nuk po kanë mundësi me shku e me e kry praktiken

**XHAVIT DRENORI**-Parashtroi disa pyetje si:pre ciles linjë bugjetore janë pagu darka e mbajtur me mësimëdhënës nga kryetari i shtetit pak para fushates zgjedhore,kur ka pasë mundësi që te paguhen ato mjete per bartjen e nxënsve me nevoja te veqanta e kjo nuk ka ndodhë, si dhe pyetja tjeter per drejtorin e arsimit është fjala për mbledhjen e radhes te na sjell një raport sa mësimëdhënës kanë shkollat me shkollë të mesme.

**IDRIZ HYSENAJ**-i njoftoj të pranishmit se darka me mësimëdhënës nuk është paguar me buxhet të Komunës

**XHAVIT DRENORI**-reagoi ndaj pergjigjes se Idriz Hysenajt ju nuk jeni kompetent për këtë pergjigje

**IDRIZ HYSENAJ**-unë në këtë rast u pergjijga në emer të grupit parlamentar të PDK-së

**HAMDI KRASNIQI**-gjithashtu u pergjigjë se darka nuk është paguar nga asnjë linjë buxhetore e komunës sepse as që kemi pasë kontratë të lidhur për këtë qëllim

**SABRIJE KUKAJ**-unë vetë kamë qenë pjesë e kësaj darke,në fillim është fakturu kjo darkë me bugjet të drejtorisë se arsimit dhe më vonë është terhjek dhe kjo kerkesë i ka shku partisë.

**RIFAT BILALLI**-pajtoj me parafolësit sa i perket kerkesës që në raport të punës mungon lista e projekteve kapitale se sa projekte janë kry gjatë vitit 2016 e sa jo ta dimë sakt ,kurrë nuk po jemi të informuar per këtë rast konkret permendi rrugen Polluzhë-Dashec që për qdo vitë ndahen nga 50.000mijë euro e punë nuk kryhet,unë e di që ministria e ka aprovu bugjetin por kur do të kryhet kjo rrugë,e sa i perket darkes më mësimdhënës te shpenzohen 7.000mijë euro është e paarsyeshme, ku kemi pasë nevojë dhe mundësi me investu në kabinete të shkollave që mungojnë e thirren gjoja po i shpenzojmë prej mallrave dhe sherbimeve por besoj se drejtori i ri do të ndryshoj dhe do tia dalë ketyre problemeve, që janë krijuar në këtë drejtori,e keqja me e madhe e organizimit te ketyre darkave është se mësimëdhënsit po humbin shumë orë, dhe nxënësit po e humbin mësimin,unë në këtë rast thërras që sa me larg të jetë politika nga shkolla,se kemi mesimdhënes që më falsifikime punojne e besa janë edhe avansuar ata mesimdhënes dhe kanë marr pozita

**NEXHMEDIN BALAJ**-ne veq sa e votum dhe e hoqem nga rendi i dites një rregullore që ishte në kundershtim me ligjet në fuqi ,sa i perket nivelit të arsimit qështja është shumë e rëndë ,me besoni kemi nxënës me dhjetra që vinë në shkollë të mesme që nuk dinë shkrim lexim kjo nuk duhet të lejohet,e ne më mirë është të kemi një rregullore per qështje të arsimit që do të na ndihmonte të vejmë rregull e ligj dhe te kerkohet që politika të jetë larg nga shkollat,

**DAUT THAQI**-u pergjigjë në pyetjet që kishin parashtruar anëtaret e kuvendit rrethë drejtorisë se arsimit:fillimisht ju drejtua zotit drenori dhe tha:se pyetjet që ju parashtruat një prej tyre keni edhe më shkrim, ne ju kemi kthyer pergjigje ,e sa i perket pyetjes se a ka mësimdhënës me shkolla të mesme ,ne kemi evidentuar të gjitha këto raste janë gjithësejt 12 mësimdhënës per parashkollor që dhanë mësim por që janë të licencuar,janë 3 student por që janë te profesionit si dhe 4 mësimëdhënës janë te muzikes me profesion e që mungojnë kuadrot me fakultet në këtë lëmi.ndersa sa i perket pyetjes se shkollat kanë një marrëveshje me feronikelin për nxënësit që do ta mbajnë praktiken kjo do të ndodhë tash e tutje,pengesat kanë qenë për shkak të gjendjes që ka pasë feronikeli ,ndersa sa i perket anafalbetizmit që u permend një gjë të tillë edhe me dashtë ligjet nuk lejojnë ,ndersa sa i perket problemeve me pagesë të disa mësimëdhënsve këtë problem e kanë të gjtiha komunat e kosoves këtu është fjala per lehonat që gjenden në pushim,dhe kjo qështje më shumë i takon ministrisë.

**XHAVIT DRENORI**-i morem disa pergjigje nga drejtori i arsimit por per mbledhjen e radhës mirë është te na sillet një raport me emer e mbiemer, sakt sa mësimëdhënës janë me shkollë të mesme,ndersa sa i perket pyetjes per darken e mësimëdhënsve pergjigja nuk është e sakt se per këtë dark je nenshkrues edhe ti i nderuari drejtor se bashku me tafil gjekajn,afet morinen,bekim gjoken e keni nenshkruar atë proces.

**RIFAT BILALLI**-pati pyetje sa mësimdhënës kemi jashtë listes se pagave

**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI** - të nderuar asambleist komuna është dasht ti kete 213 punëtor, ndersa i ka vetëm 143 punëtor në komunë, kemi pasë nr.me të vogel të punëtorve se sa që është dashtë të ketë ,por dhe ka të punësuar pa konkurs që kanë ardhë ,dhe qdo i punësuar që ka ardhë pa konkurs do tu nenshtrohen procedurave sipas ligjit dhe do të shpallet konkurs per ato vende,dhe nga tash e tutje qdo i punësuar do jenë vetëm ata të cilet i plotësojnë kriteret sipas ligjit,do të jenë të kualifikuar dhe të profesionit nuk ka mundësi dikush tjeter me ardh,e sa i perket vrejtjeve per zhvillimin e punimeve në teren komuna ka kontratë per mbikqyrje me një kompani,unë kësaj kompanie do ti japë vrejtjet e mia,e sa i perket punimeve në teren unë ju garantoj se punë do të kryhen vetëm sipas projektit , secili qytetarë do të njoftohet me paramasen dhe ne do të bashkëpunojmë me qytetarë e nuk do të lejojmë që punet te kryhen shkel e shko vetëm sipas projektit ne të kunderten ne do të marrim masa.

**SABRIJE KUKAJ**-ju po kerkoni me rritë nr. e punëtorve a në fakt po i largon punëtoret nga puna qdo ditë ,rast konkret permendi mihrije gjoken që është në gjendje të rëndë shendetsore,dhe ke punësuar pa konkurs punëtor rast konkret permendi emrimin e drejtoreshës në gllobar

**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI**-sa i perket rastit në gllobar u pergjigjë se nuk e kamë emruar drejtor, nuk është e vertetë është ushtrues detyre, deri sa te shpallim konkursin,ndersa sa i perket asaj se une kamë larguar punëtor nga puna nuk qendron, perkohsisht i kamë suspendu punëtoret që kanë akuzë, ndersa punëtoret të cilet nuk vinë tri ditë pa arsye në punë me ligj e humbin te drejten e vendit të punës e mihrije gjoka një kohë të gjatë ka marrë rrogë pa ardhë fare në punë.

**NEXHMEDIN BALAJ**-pse u bë anulimi i një konkursi në shkollen Luigj Gurakuqi arsya është jo serioze dhe banale,gjoja se nuk ka pasë konkurent e që në fakt kjo nuk qendron se unë e di se ka pasë konkurent .

**DAUT THAQI**-deklaroi se unë nuk jamë i informuar për këtë rast
**NEXHMEDIN BALAJ**-ligji shumirë e percakton si të jenë 3 kandidat konkursi nuk mundë të anulohet,është shumë i paarsyeshëm anulimi i ketij konkursi gjoja se nuk ka pasë kandidat gjoja se ka qenë vetëm nje kandidat në gare ,arsyetimi ka qenë shum banal nga DKA-ja
**SABRIJE KUKAJ**-me mihrije gjoken shumë keni gabu që e keni largu nga puna,në vend që ta ndihmojmë që ka pasë edhe kerkesë për ndihmë ju ja keni nderpre marrdhenjen e punes
**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI**-perseriti edhe një herë se ligji i punës thotë se nëse punëtori mungon tri ditë pa arsye i nderprehet marrëdhënja e punës
**RIFAT BILALLI**-sa është numri i punëtorve jashtë listes se pagave
**DORENTINA BUNJAKU**-sa i perket ilirit kryetar ai prej kohes kur keni ardh ju kryetar ka qenë i rregullt në punë e per periudhen kur ka qenë nexhati ai është ardh ashtu siq ka kerkuar nga ish kryetari
**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI**-Nuk është e vertet që Iliri ka ardh i rregullt në punë, ky nuk ka qenë i punësuar në zyren time, ka qenë i punësuar në drejtorin për shërbime publike, dhe në këtë rast ka qenë komisioni ai i cili ka konstatuar se Iliri ka pasur më teper se tre dit që nuk është lajmruar në punë, dhe ligji shumë mirë e thotë se punëtori nese mungon tre ditë pa arsye e humbë vendin e punës.
**DORENTINA BUNJAKU**-Nuk është në rregull kryetar , komisioni ja ka ndërruar deklaraten dhe nuk është ajo deklarat qfar ka thënë Iliri.
**DAUT THAQI**-pati pyetje se sa mesimdhënës janë jashtë listes së pagave: Unë kamë konstatuar se për momentin janë 22 por kjo levizë, mund të jenë më teper por edhe mund të jenë më pak.
**NAIM BAZAJ**-hapi diskutimin për piken e tretë të rendit të dites

**3.Raporti vjetor i buxhetit për vitin 2016**

**HAMDI KRASNIQI**-Dha një arsyetim rreth këti raporti dhe në këtë rast i njoftoj anëtaret e kuvendit se ky raport paraqet të dhënat duke filluar nga planifikimi i buxhetit e deri në realizimin dhe shpënzimet e këtij buxheti për vitin 2016,sa i perket mbetjes se mjeteve te pa shpenzuara u arsyetua se ne kemi pasë shkresë edhe nga ministri por edhe nga zyra e kryeministrit se deri me cilen datë është lejuar shpenzimi dhe i prezantoi shkresat para anëtarëve të kuvendit
**VEHBI BERISHA** –Pati pyetje: Pse nuk janë shpënzuar mjetet siq kanë qenë të planifikuara por kanë mbetur më teper se 514,662.75gjysmë milioni mjete të pashpënzuara nga të hyrat vetenake , arsyetimët e drejtorit po më dukën jo bindëse,sepse une kamë hulumtu dhe kamë gjete se në shkresat e ministrisë se Financave, shkurtimet buxhetore kanë ndodh per të gjithat komunat e kosoves. Këtu kemi mjete të pashpenzuara edhe të vitit 2015 dhe vitit 2016 qdo vit po bartën mjete nga viti në vit, dhe nuk po shpenzohen, ndërsa sa i përket numrit te të punësuarve në komunen e Drenasit unë kam parë se në shëndetsi kemi numrin më të vogel të te punësuarve, qka do të thotë se kemi nënpunësim, pse nuk hapën vende te reja të punës dhe te hapet konkurs dhe të plotësohen ato vende.
**SABRIJE KUKAJ**-Si është e mundur që të mbëtën 380.000(mijë) euro pa u shpënzuar, në këtë rast për këtë qështje duhët jap pergjegjsi dikush dhe këto mjete është dashtë të shpenzohen vitin e kaluar, po thirrën se nuk ka staf të mjaftueshem në prokurim, por kjo nuk qëndron dhe në këtë rast mori një shembull se asgjë më e komplikuar nuk është një lënd në prokurim se sa një

lëndë në banka ku shumë më shumë ka punë këtu ku e thashë dhe puna kryhet, ndërsa në prokurim thuhet se nuk ka staf.
**LIMAN KRASNIQI**-pati pyejte: Qka mendon egzekutivi dhe si të veprojë në të ardhmen për bartjen e mjeteve vetanake nga viti në vit, por unë kamë një kërkes qe stafi profesional te mos leviz prej drejtorive perkatse sidomos drejtoria e urbanizmit dhe zyra e prokurimit se puntoret që aftesohen për pregaditjen e tyre ju duhet nje kohë se procedurat e prokurimit e pamundesojn nje realizim të buxhetit ashtu si ne mendojm ,kisha kerku sqarim nga drejtori i financave se ne cilen kohe ka ardhur deri te zotimi i mjeteve apo alokimi që kta nuk kanë mujt me vazhdu as me kontrata pa u kryer ato procedura.
XHAVIT DRENORI-jemi te pika e rendit të dites Raporti financiar per vitin e kaluar,ndersa për me e sqaru opinjonit se pse jamë me kete trasparente, është se jamë i shqetesuar dhe ndihem më të vertet jo mire si qytetar i Drenasit që të vjen nje zyrtar nga niveli qëndror aq me pak i një komune tjeter edhe të intervenoj se kush me hy ne punë dhe kush mos më hy ne administrate komunale ne drenas, per mu besoj që është e pa pranushme dhe për qdo qytetar tjeter,prandaj kjo është një shenjë proteste.
Po ndalem të pika e rendit të dites,shumicen nga qeshtjet që u thane realisht pajtohem.problemi me i madhe po mbetet te suficiti buxhetor zotri kryetar është sfid shumë e madhe masi ta pastroni Arsimin, nga keqmenagjimi ti ktheheni urbanizmit sepse po ju them shumë sinqerisht me na tepru neve 308 mije euro grande qeveritare me u kthy mbrapsht ne qeveri edhe ato mjete nuk na vine ma humbim, më të veret është e e pa pranushme duke marre parasysh ne qfar gjendje kemi ne teren,aq me keqë arsyetimi jepet se nga zotimi te hapura pas dates 08.12 thesari e ka pamundesuar në nxjerrjen e urdhërblerje të konsideruar mjetet si tepric ,qfar menagjim është kur mbesin 308 mije për dy apo tri dite në fund vit kjo është e pa pranushme ,ketu sot është dasht me dhanë llogari para nesh e jo me kalu si herave të kaluara ,une muj me fol për dy projekte që jamë kah i monitoroj njera ne fshatin tim të lindjes ne dobroshec, që është shty për sivjet aty është shty vetem për fushat politike dhe është vit zgjedhor, pergjegjsinë kryesore e ka drejtori i urbanizmit për kete menagjim të keq të financave, sidomos ato që vinë nga grandet qeveritare ,une du nje sqarim pse 308mije euro na u kanë kthy mbrapsht dikush duhet me dhanë llogari per këtë.
**HAMDI KRASNIQI**-Unë i mirëpres sygjerimet dhe rekomandimet e juaja dhe në këtë rast unë do të perpiqem qe të pergjigjem në pyetjet i parashtruat, po përgjigjem fillimisht tek pyetja e Vehbi Berishës është fakt se 514.000(mijë) euro mjete të pasjpënzuara për komunën tonë janë shumë, por po ju njoftojë se pas datës 30 tetor komuna më nuk ka të drejt të lidh kontratë për asnjë investim kapital, ndërsa sa i përket shkurtimeve buxhetore i keni të sqaruara në faqën 3 dhe 4 të këtij raporti.
**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI**-Ju drejtua Xhavit Drenorit po ta kthej edhe ty si Ganis, deshta me të banë Drejtor por s'mujta më të banë se nuk kishe besim te vetvetja jote,edhe atë qiken deshta me e banë drejtoresh po u tërhoq vet por te kryme e keni të dytë.
**SABRIJE KUKAJ**-Nëse kanë mbet mjetet pa u shpënzuar në mungesë të kontratave këtu dikush duhët të jap përgjesgjësi kur ju deklaroni se zotimi i mjeteve veq paska qënë i kryer.
**XHAVIT DRENORI**-e falenderoj drejtorin per pergjigjje edhe pse për mua është totalisht e papranushme edhe e pa justifikushme të mbetet kaqe shumë e

madhe e mjeteve, pa u shfrytezu me arsyetimin se prej me pake se dy jave dite me mbete ajo shume pa u paguar,ne vitin e kaluar kam fole kogja shum pa dorza per dallaveret që behen ne urbanizem, e para kur te jepet tenderi jepet 10%,e dyta zyrtaret komunal që dalin me i monitoru projektet pa hanger diqka nuk kane ece ,ata që pranojn teknikisht prap pa hanger diqka nuk e kanë lan, edhe prap ja vonojnë pagesat ,prandaj në prapasken vonesat për pagesa janë pikerisht që tu dhe firmave ju ka ardhe të hund tuj i pagu secilin staf të te punësuarve deri sa i kane marre mjetet e veta për punen që e kryejn ne teren.
Sa i perket kryetarit që tha per emerimin e drejtorit, une thash e pergezoj edhe e uroj vetem edhe diqka te ju them juve nuk mund të behem une drejtor i Arsimit, nese kryetari i komunes mu si antar i kuvendit më sjell tre muaj më rrapadit zyreve her ne zyre të avokatit ,her ne zyre të agjensionit për mbrojtjen e të dhënave për nje informat shumë të shkurter, qeshtje të arsimit, aty tregohet serioziteti i juaj se sa jeni të interesuar me e pastru arsimin, nuk qendron e verteta që nuk kamë dasht me u ba drejtor, përkundrazi shumë kamë pas nevoj me qene drejtor po jo drejtor i juaj sepse ju nuk jeni serioz
**KRYETARI I KOMUNËS- RAMIZ LLADROVCI**- Ju drejtua Xhavitit që ku është Betimi sot po të emroj drejtor te urbanizmit, hajde nisja punës edhe kryje punen dhe nuk të perzihet askush në pune ,por nuk je kanë edhe sje i zoti me e marrë detyren, por je i zoti veq me u mundu me fole, po të themë sinqerisht
**XHAVIT DRENORI** -Nese e ke perime unë sot e pranoj këtë detyrë por ti nuk je serioz
**BETIM BERISHA**-U ngrit në këmbë dhe deklaroi se nësë ti je i gatshëm dhe e pranon këtë detyrë i lirë je dhe nesër prej ores 08:00 ta dorëzoj detyrën e drejtorit të urbanizmit dhe vetëm të uroj sukese.
**LIMAN KRASNIQI**- e falenderoj drejtorin e financave se shum mire e sqaroj ne aspektin financiar bartjen e mjeteve të mbetura prej vitit në vit ,por pyetja e ime ka qene, qka keni bëre rreth kordinimit më drejtorin e urbanizmit që ne kemi projekte të cilat janë të planifikume me mjete vetanake por janë pa u perfundu,e tash më fillu që ato mjete vetanake të shpenzohen edhe të mos mbetin per vitin e ardhshëm,ndersa sa i perket zotriut që ja uroni për me shku drejtor i urbanizmit unë i kisha propozu kryetarit që ne urbanizem për jasht profesionit të mbetet zotnia që është, nese e keni nje ingjinjer të artitektures ose të ndertimtaris urdhnoni edhe vendoseni se per ndryshe njerzë jashtë profesionit mundën me na deshtu, zotria ne fjale që është i ka mesuar disa qeshtje edhe sivjet eshte me mir ne raport me shpenzimet se s viteve tjera.
**NAIM BAZAJ**- hapi diskutimin për piken e katërt të rendit të dites
**4.Propozim vendim për bartjen e të hyrave vetanake**
**HAMDI KRASNIQI**-i njoftoj te pranishmit për bartjen e mjeteve nga viti 2016 ne vitin 2017 ne shumen prej 514.668.75 euro, dhe ne kete rast permendi te gjitha mjetet nga te gjitha kategoritë e bartura si:nga pagat-8,968.00euro Mallra dhe sherbime-12.147,80 euro,subvencione-4.204.33 si dhe shpenzimet kaapitale 489.347.21euro
**XHAVIT DRENORI**-të shpenzimet kapitale kemi mjete që janë bartë prej vitin ne vit dhe hasi tek kodi i projektit 89091 dhe aty e gjejm se është ndertimi i rrugeve lokale ,asfaltimi i rruges ne fshatin Dobroshec (lagjia Hajdari dhe Shishani ) ketu është nje gabim edhe po shpresoj që është vetem gabim teknik, se projekti ka qene i miratuar me u realizu vitin e kaluar nga buxheti që është aprovu ne vitin2015per vitin2016 dhe janë tri lagje të perfshime lagja Hjadari ,Ademi dhe Shehu jo Shishani ,prandaj ne duhet të kemi kujdes sepse projekti

ka filluar vitin e kaluar por per shkak të disa problemeve është shty për kete vit kështu që duhet të permisohet kjo.Në pergjithsi jame shum i shqetesuar pse kjo shume kaq e madhe e mjeteve eshte dasht me u bartë në këtë vit e sesht realizu gjat vitit te kaluar ashtu siq ka qenë edhe planifikimi
Kërkoj sqarim rreth shpënzimit të mjeteve për projektet kapitale dhe bartjen e këtyre mjeteve nga viti në vitë dhe në këtë rast kërkoj të informohet saktë se për projektin e rrugës në Dritan (Dobroshevc) ku me vendim të kuvendit për vitin 2016 projekti përfshin 3 lagje si lagjet Hajdari, Shehu dhe Ademi ndërsa sot ky projekt përfshin lagjet Hajdari dhe Shishani te mbetet siq ka qenë me vendim
**HAMDI KRASNIQI** --gabim teknik nuk mundet me qen jamë i sigurt - --Xhaviti atëher ne duhet te kemi nje arsyetim ,hamdia --arsyetimin e jep drejtori i urbanizmit
**VEHBI BERISHA**-Unë shoh se këtu kemi tri projekte në një fshat vetem me kode të ndryshme dhe më mirë ka qënë që të përfshihen 3 fshatra me nga një projekt se sa tre projekte në një fshat.
**SOKOL BYLYKBASHI**-Ne e dimë të gjithë se mjetet nga të hyrat vetanake nuk humbin por bartën nga viti në vit, por mjetet e planifikuara duhët të shpënzohen jo të bartën, por unë në këtë rast kisha kërkuar që këto mjete të bartura të jenë të parapara për 3 projekte për mbikalim si te hekurudha në Drenas, në fshatin Zabel dhe Arllat.
**SABRIJE KUKAJ**-Kërkoj të di se këto mjete të bartura a janë paraparë për projekte që janë caktuar me vendim të kuvendit apo jo, në këtë rast unë kisha kerkuar që të ndahën mjete për shpronsim të lumit Drenica sepse ka shumë nevojë.
**IMER DELIU**-Kërkoj që për projektin në Abri që është lagjja Hajdari dhe Hyseni të përfshihën dhe lagjet Muliqi dhe Asllani.
**SHQIPE ZOGU**-propozoi që mjetet e parapara nga subvencionet në drejtoratin per bujqësi dhe zhvillim ekonomik në vlerë prej 1.371,95 euro të shkojnë ne mbështetje të Strategjis për Gratë ndermarrse në komunen e Drenasit, Strategji kjo për të cilen organet e egzekutivit janë kompetente per me u miratu kështu që kisha propozu që këto mjete të shkojne si Subevncion per gratë që mirren me sera ose per grat që merren me artizanale te ndryshme
**XHAVIT DRENORI**-drejtor keto projekte a janë projekte që kanë kaluar me vendim të buxhetit të vitit të kaluar e që janë shty projektet, sepse dikush kekroj më i nderru destinacionet ,ne nderrimin e destinacioneve duhet të kemi kujdes sepse kemi të bejm më vendimin rreth buxhetit e nuk kemi të drejtë me nderru ,une pata nevoj per sqarim ne Dobroshec,ketu figuron lagja Hajdari,shishani,ju e dini shume mir se punet kanë fillu ar në teren dhe janë tri lagje lagja Ademi,Hajdari dhe Shehu e jo Shishani
**BETIM BERISHA**-i njoftoj te pranishmit se keto mjete që sot po kerkohet të bartën janë mjete të mbetura nga projektet kapitale, dhe ne me teper jemi orientuar në projektet dy vjeqare që kemi dhe kontrata të lidhura për keto projekte,e sa i perket shpronësimit ky është një projekt madhor dhe me mjete të komunës nuk mundë të kryhet,ndersa sa i perket sqarimit ne Dobrishec ai është vendim i kuvendit ku është lagja Hajdari,Ademi dhe Shehu, ketu është nje gabim teknik në ministrin e financave ne pip ne kemi shkuar me vendim të kuvendit, projekti nuk ka mujt me u perfundu vjet se kemi pas disa probleme me banore dhe ne i kemi stopu, se njeher kanë dashtë më shku vetem ne nje lagje pastaj dy përfundishmish fshati është pajtu që ai projekt të shkoj në tri lagje edhe ne sa po diskutojm ketu punet janë duke u kryer atje

**HAMDI KRASNIQI**-ne nuk kemi të drejtë te shpenzojmë mjete nga një kategori në kategorinë tjeter të shpenzimeve këtë duhet ta keni parasysh të gjithë.
**SABRIJE KUKAJ**-mjetet që kane qene vitin e kaluar për shpronsim a kanë qene prej grandeve dhe pargingu të qendra tregtare a ka qene prej grandeve se nuk është kry
**BETIM BERISHA**-ne qe dy vitet e fundit kemi kriju të hyra që quhen të njëhershme, dhe ministria e financave e ka planifiku që komuna e drenasit me i planifiku te hyra 1 milion e 500 mije euro, është ardh ne qarkore dhe skemi pas qare, dhe kemi reagu sepse raporti 4 vjeqar i të hyrave te drenasit është prej 1 milion deri me 1milion e 100 mije euro, është e pa mundëshme me i kriju 1milion e 500 mije euro të hyra, dhe ai projekt është mbet.
**SABRIJE KUKAJ**- a nuk e keni pas prioritet atë parking që sa vite në qfar gjendje është
**BETIM BERISHA**-vjet nuk ka hy gjatë degjimit të pare e as të dytit sepse ato projekte që janë hy per sivjen kanë me u kry ,derisa ajo nuk ka hy nuk është miratu në kuvend në shtator .
**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI** -zonja Sabrije une do ti inkasoj 127 mije euro të feroniklit që nuk ja keni marrë prej 2012 dhe e keni falë ne vitin 2016 ,pra ne momentin që do ti marrë mjetet prej feroniklit në rishiqim ka me qene parkingu i shtrume edhe pse ajo zonë po pretendohet diqka tjeter ,prandaj une pargingun kom me e banë ne jemi ne proces gjygjsore në atë zone ,jo vetem me ata që ja keni aprovu me e ndertu stacion edhe objektet perreth 600 milion euro, dhe të dytin ma banal 400 mij euro, por është nje zonë e cila po pretendohet se ka dokumenta që ja ka dhene serbia ja ka fale, ne po luftojm me e hupe atëfar pune edhe me e ndreqë parkingun, 127 mijë euro edhe 60 mijë per kete vit feronikli i ka borgj komunës 187 mije euro gjithësejt
**NAIM BAZAJ**-hodhi në votim këtë pikë të rendit të dites më ndryshime
Me rastin e votimit prezent ishin 26 anëtar
Rezultati i votimit ishte si vijon:
Për:22
Kundër:02
Abstenim:02
**NAIM BAZAJ**-hapi diskutimin për piken e pestë të rendit të dites
**5.Propozim-Rregullore për kushtet,kriteret dhe procedurat e ndarjes së Subvencioneve**
**HAMDI KRASNIQI**-Lidhur me këtë propozim rregullore,deshta me ju njoftu se në këtë dokument kemi punuar gjat ,dhe inciativa ka qene fillimisht i auditorit të pergjithshëm që gjitha organizatat buxhetore të cilat shpenzojn paranë publike në kategorin ekonomike në subvencione dhe transfere,ne duke pare një rendesi të veqant ne menyren e shpenzimit të tyre ,edhe pse kemi nje rregullore që është miratuar nga kuvendi komunal përmes se ciles po meren vendime per të shpenzuar paratë në këtë kategori ekonomike.dy dokument ka edhe disa materjale shtesë se si do të implementohen, si qështë me rendsei forma e raporti financiar kthyes ,vendimi i kryetarit dhe marrveshja që do të lidhet me perfituesin e mjeteve nga kjo kategori e shpenzimeve.konsiderjo se ky dokument është më i avansuar se sa ai qe kemi deri me tash sepse kontribute kanë dhene siq janë:koligjumi i drejtorve për arsim ,shendetsi ,per buxhet dhe financa dhe kontrimbu të veqnat ka dhene koligjumi i zyres ligjore që janë organ profesionla për të ja dhene formen si dok.zyrtar,procedura për shpenzimin e subvencioneve nga komuna do të zhvillohet mbi bazen e thirrjes publike,dhe gjith procedurat

tjera do të kryhen përmes komisioneve që do ti caktoj kryetari,uroj që ky dokunent pas miratimit të kemi nje bazë ligjore nga e cila do të mbeshtetemi per ta shpenzuar parata në kategorin e subvencioneve

**SHQIPE ZOGU**- e kamë lexuar këtë dreft rregullore është per tu lavduar,por kanë dy propozime për këtë draft rregullore ,të neni 20, paragrai 2 dhe nënparagrafi 2.3 ku thote flet posedim për patundshmëri dhe njeri prej dokumenteve të nevojshme për të aplikuar për subvencione,duke pasur parasysh se shumica e qytetarve të komunës së Drenasit ende nuk i kanë kryer procedurat për trashegimi edhe shumica e pronave të aplikuesve per subvencione ende janë ne emer të persovave të vdekur ,kisha propozu që në rast kur mungon posedimi për patundshmëri të mirret për bazë edhe nje deklarat noteriale me të cilen deshmohet se aplikuesi është trashigimtar potencial i asaj pasurie si dhe nje Certifikatë ose deshmi e vdekjes në të cilen figuron emeri i trashigimislenësit edhe trashigimtaret e domosdoshem dhe kjo e kish lehtesu proceduren ,gjithashtu të neni 23 ku është raportet kthyese nga perfituesi i subvencioneve pika 1 i ketij neni, duke pas per bazë se ne posedojm gjithmone më shume që qdo para e shpenzuar të kete nje destinim të barabart gjinor, kisha propozu që ketyre raporteve financiare të ju shtohet edhe nje statistik që sa persona kan qene përfitues ne baza gjinore sipas përfitimeve të mjeteve psh.nese dikush perfiton ne vlere 5.000 euro sa janë perfitues gra dhe sa meshkuj

**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI**-shqipe une jamë dakort më e shtue deklaraten noteriale dhe qertifikaten apo deshmin e vdekjes, por duhet më thene së e shtojm edhe nje deklarat për të gjithë aneteret, trashigimtar të asaj pasurie, që heqin dore ne dobi të atij që aplikon,sepse ne mundë të na vijnë 2 apo 3 të një familje me të njejten gjë, nuk prish asgje nese nje deklarat me të gjithë anëtaret të familjes hjekun dore per të perfituar ai.

**SOKOL BYKYKBASHI**-me vejn mire qe zyre e kryetarit dhe drejtorit tjera kanë filluar që të hartojn rregullore të ndryshme dhe shpresoj që kanë me e vazhduar këtë trend,sa i perket rregullores është nje rregullore e punuar mire shumë pozitive ,dua të ndalem tek neni 23 dhe neni 24 se kemi pasur mangesi në të kaluaren,më vjen mirë që egzistojn këto nene dhe shpresoj që kanë me u implementu plotesisht, sa i perket nenit 23 raportet kthyese nga perfituesit e subvencioneve, ju e dini se subvencionet që i kemi dhënë në fusha të ndryshme në bujqësi,shëndetsi dhe ne fushen e kultures , asnjeher nuk kemi marrë ndonje raport se nga janë shkuar ato mjete ,përveq që nuk kemi marrë ne si asamble por nuk kanë marre as drejtorit për shkak se kështu thojke më heret edhe raporti i auditorit të pergjithshëm,sa i perket neini 24 monitorimi i perfituesve të suvencioneve edhe kjo eshte e rendesishme per shkak se nese ti kërkon vetem raport pra gjithqka ka përfunduar ,të pika 1 dhe 2 të neni 24 aty ku thuhet komuna ka të drejt të inicoj ose do të inicon auditim përfituesve nga komuna ,dhe aty ku thuhet se komuna mund të bëjë, të jetë komuna bënë të jëtë sepse kjo duhet të merret si obligim për shkak së te gjitha duhet të monitorohen edhe të kontrollohen .

**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI**-sokol pajtohem plotesisht mund të lamë edhe mund të bëjmë edhe bënë se në kur dyshojm dikund në i bëjme monitorimin

**XHAVIT DRENORI**- e kamë lexuar me vemendje këtë propozim rregullore ,po ndalem tek neni 2 është mire me ju shpjegu qytetarve se jemu duke fole për para që i mbledhim nga taksat e tyre, dhe ato para kemi vendos nje pjes prej

tyre më i mbeshtet financiarisht disa organizata, duke pase parasysh që profiti që ato organizata respektivisht institucione bëjnë edhe në te miren e gjith qytetarve të Drenasit,tek neni 6 me vejn mir që është percaktu perjashtimi i ndarjeve të subvencioneve, kamë nje pyetje per Kryetarin a keni mujte me mbledh informacione respektivisht më u ber nje auditim i subvencioneve që janë dhënë ne keto vitet e fundit ,neni 7 komisoni për shqyrtimin dhe vlersimin e kerkesave per ndarjen e subvencioneve ketu kamë shume pyetje edhe kisha dashtë dikush ligjerisht më u pergjigje ,nese i marrim edhe i shiqojm të drejtat dhe përgjigjsit e anëtërve të kuvendit dhe egzekutivit në ligjin per veteqeverisja lokale hasim shume qeshtje se edhe kuvendi ka pergjegjsi,ketu askund nuk mujta më hase që në komisione do të perfshihen edhe ndonje anëtare i kuvendit, une jamë idhtar që nga dita e pare që le te denctralizohet qeverisja lokale jo vetem te egzekutivit po ti jepen pergjegjsi edhe anëtarve te kuvendit, sepse keta njerz i ka zgjedh populli,ligjin per veteqeverisja lokalë e ka parapare që të behen komisione pse mos ta kemi edhe ne nje komision z,kryesr prej kuvendit komunal i cili kish qene nje lloj vezhguesi ose ndihmuesi në këtë rast i punes suaj per ndarjen e subvencioneve pse ju duhet me lype të shoqeria civile a e gjeni dikend apo e gjeni dikend të njofshem ,une nuk e di a e ka parapa ligji që kryetri mundet me e ndal kete kopetenc për vete apo mund ta ndaj edhe me anetare të kuvendit ketu është dasht më lype ligjshmerin edhe nga MAPL-ja nese kete pergjigje nuk e kthen egzekutivi ketu eshte çdo kund kryetari.ti pika 4 nenit 8 komisioni mbane proces verbal nga mbledhjet e saj i cili duhet të nënshkruhet nga anëtaret e komisionit ,a mundesh z,kryetar më autoritetin e juaj krejt qeto proces verbale me i publiku ne ueb faqe te komunes ,une si antar i kuvendit jamë terr informativ se kah po shkojn paret e qytetarve .

**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI**- tek neni 2 është e cekur personave fizik dhe juridik ju jepet subvencione ,të neni 6 pika 4 auditimi i subvencioneve që janë edhe gjatë viteve të kaluara a kanë ber auditim,une nuk kame ber auditim, por te vitit të kaluar i kamë kerku raportet kthyese të gjitha ketyre OJQ-vë që ju ka dhënë nje here, ose vitin e kaluar asamblea prandaj problemi i feroniklit është ngrit ketu për me ma lanë mua fain, sikur une nuk po du me ju dhanë une feroniklit,une propozim vendimin për feronikel e kamë bere gati më 30.000mijë euro, por edhe ne kete rregullore ceket së personat fizik dhe juridik nuk mund të marrin paga dyfish edhe prej subvencioneve të komunës, edhe më punu në komunë ose në Arsim, prandaj une i kamë kerku raportin dhe kur te vime të ajo pike do ti lexoj me emra se kush janë perfituesit e subvencioneve ,pra kemi kerku raport kthyes për vitin e kaluar jo për vite tjera,pse nuk mundet me qene pjesë e komisionit edhe asambela është sepse është konflikt ineteresi, nese ti je në komision për ndarje të subvencioneve, dhe ti ke më votu menjeher është konflikt interesi ,në këtë rast Z.balaj ka propozu në mbledhjen e KPF-ca më hy ne rend dite feronikli pa kërkesen time, edhe ky është nje konflikt interesi sepse z.Balaj ka marre pagë edhe prej subvencioneve edhe prej arsimit edhe si trajner edhe si asambleist pra është nje shkelje ,neni 8 po Xhavit do ti publikojm në ueb faqe te komunes krejt subvencionet që do ti ndaje, prandaj ka kerkesa deri në 1500euro kamë mujt me i nda ,sepse vendimi i juaj ma lejon me i nda subvencione deri ne1500 euro, une e kam bere 1510 vetem me kalu permes jush ose ju me vendos më e nda apo mos më e nda atë subvencion për me e hjek pergjegjsin nga vetja që mos mëm thanë dikush se ja ka nda tezes ,dajes,mikut apo shokut

**NEXHMEDIN BALAJ**- T'ja rikujtoj kryetarit që une jamë sportist dhe merrem qysh ne moshen rinore,aktivitetin e sportin nuk mund të ma ndal Kryetari, edhe pse informohet më të pa vertetat sepse une e kame kontraten ne klubin e futbollit feronikelit per angazhim dhe pune vullnetare dhe asnjeher aty skam marre rroge ,ta argumentoj më çdo fakt ,e kame vetem nje rroge kur e kamë nënshkru kontraten e parë ,une nuk e di se qka kane shkru ata, ty une te garantoj që skam marre rroge aty,zerat që kane leviz është se une po i marrë tre rroga une jamë ardh në dilem se ose me e leshu Asambelene ose klubit me i ndihmu më punë vullnetare, dhe i kamë dy kontrata të nënshkruar nga klubi feronikeli që une aty kamë aktivitet vullnetar edhe nese per nje pune vullnetare është konflikt interesi une nuk di se ku më shku dikund tjeter, une e du sportin jamë për më i ndihmu sportit po jo në gjendje qysh po i etiketoni personat me emra dhe të pa verteta

Kryetai –une qetapata qef me e ndegju nga ti

**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI**-z.Nexhmedin Balaj ke marre pagë sipas raportit te feroniklit për periudhen 16 maj deri me 31 maje 2016 ke marre page 21.05.2016 paga 250 euro nga subvencioni që ika dhënë komuna ne vlere prej 15.000 euro ,a ti lexoj edhe ata që janë në arsim

**NEXHMEDIN BALAJ**-une e pranova që e kema marre nje pagë ,po ne momentin që e kamë ndie që është jo morale, jo njerzore të mirren dy paga, unë jamë terhjek nga paga ne klub, edhe kontraten e klubit e kamë pune vullnetarë, ku punoj me 110 femije të moshes deri 11 vjeqare,dhe aktiviteti im i shtuar eshte 5 her në dite nga dy ore dhe të bëshë këtë pune vullnetarë dhe të sulmohesh nga ti në këtë form ,kryetar je duke i perdor të pa verteta informata të gabuara më sulmu njerz të caktuar ,po të sygjeroj që informohu mir sepse edhe rregulloren ne arsim e ke pru pikerisht prej ketyre persona që po te informojnë gabim

**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI**- të kërkoj faljë Nexhmedin nëse të kamë akuzu pa bazë une vetem kamë kërku raport kthyes, subvencionet nuk ipen për paga ,prandaj ta kamë numru pagen sepse ata e kanë qite e jo une dhe kekrroj falje nese të kamë ofendu ne kete rast une vetem shëmbull e kamë marrë

**NAIM BAZAJ**-nese keni nevoj per debat ja kishim leshu sallen edhe debatoni dhe respektoni rregulloren e kuvendit sepse mbledhja do të zgjate deri ne ora 16:00, Kryetari –nese don dhe ke vullnet me vazhdu mundesh deri ne ora 12:00 te nates me vazhdu,idrizi kanë të drejt per replika naimi --Idriz këshilltar i kujt je i imi apo i kryetarit –Kryetari –as i imi e as i yti

**Naim bazaj**-nga ky mohent nuk do të jemi më pjes e Grupit Parlamentar qetu mbrenda asamblesë

**NAIM BAZAJ**-hodhi në votim këtë pikë të rendit të dites më ndryshime

Me rastin e votimit prezent ishin 24 anëtar

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për:24

Kundër:0

Abstenim:0

**NAIM BAZAJ**-hapi diskutimin për piken e gjashtë të rendit të dites

**6.Propozim vendim për mbeshtetje më mjete financiare Qendrën për Rehabilitim "Handikos" -dega në Drenas ,**

**NAIM BAZAJ**-ne në Komitet per politik dhe financa kemi propozu që me ju nda 10.000 euro

**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI**-e kamë marre nga drejtori që ma ka paraqite këtë propozim per ndarjen e mjeteve për Handikosin dhe në kemi mendu që më intervenu më menyre urgjente për 5.000 euro, dhe KPF-ca ka kërku që me u nda në 10.000 euro, dhe une kamë kërku që Handikosin me e ndihmu me 15.000 euro, dhe nuk kamë pru tjeter propozim vendim, dhe kerkoj në këtë mbledhje që Handikosit më iu nda 15.000 euro, në dy rata nese edhe ju pajtoheni nese jo unë jamë per 15.000 euro me ju nda.
**XHAVIT DRENORI**-nuk po me duket e arsyeshme her 5 mije euro e her 15.000 mije euro, ne e kaluam me heret nje rregullore për subvencione edhe për këtë duhet me e pas nje projekt për me i nda mjetet,a kemi ndonje projekt nga handikosi që me i shti ne pune keto 10.000 apo 15.000 euro,une kamë deshir me e ditë se nga po shkojnë këto mjete që po i ndajmë më qenë trasparentë
**SOKOL BYLYKBASHI**-une jamë idhtar që qdo propozim vendim të jete i shkruar ashtu siq propozohet edhe më u votu,sa i perket propozimit është i mirseardhur që të votojmë propozimin për handikos në vlerë 15.000 euro, për shkak së nevojat janë shumë të medha, dhe puna që bënë handikosi është shumë e rendësishme për ato shtresa ,une e pata vizitu Handikosin dhe u njoftova më punën që e bëjnë ata ,më raportet që i pregadisin dhe më kerkesat që i dergojn komunës ,ma kanë then që nevojat e tyre dikund 20.000 euro për ti mbuluar shpënzimet e tyre e përkrahu këtë propozim vendim.
**SABRIJE KUKAJ**-ne e kemi perkrah edhe në komitet per politik dhe financa këtë propozim per 10.000mijë euro, por 15.000mijë euro duhet të kemi parasysh se drejtoria e shendetsisë ka edhe projektet tjera dhe kategori tjera që duhet ndihmuar ka familje që nuk kanë ndoshta miell
**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI**-mesuese mir e ke une ta kamë shpjegu së per Handikos kemi më berë edhe me shumë se 15.000euro ,jamë duke u mundu më ju bëre edhe nje makine më lift që ta kene më të lehtë , nese ka më pase problem ne raste të subvencioneve 15.000 euro, për handikos dhe në blerje te miellit Tushi i ka nja 10mije klg miell dhe gjysmen e tyre i jepe donacion për më i plotesu kerkesat e tyre për miell.
**NEXHMEDIN BALAJ**-nese kryetari e sheh të arsyeshme dhe ka mjete më i mbulu 15.000 euro ,une jamë Pro që të hidhet ne votim propozimi i parë i kryetarit, por ka edhe subvencione edhe nga zyra e kryetarit dhe ka mundsi që 10.000euro nga nga subvencionet e shendetsis dhe 5.000 euro nga zyra e kryetarit
**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZLLADROVCI**- kerkoj që 10.000 euro te ndahen nga drejtoria për shëndetsi dhe 5.000 euro nga zyra e kryetarit
**NAIM BAZAJ**-hodhi në votim këtë pikë të rendit të dites dhe propozimin e kryetarit per 15.000 euro
Me rastin e votimit prezent ishin 24 anëtar
Rezultati i votimit ishte si vijon:
Për:24
Kundër:0
Abstenim:0
**NAIM BAZAJ**-hapi diskutimin për piken e shtatë të rendit të dites
**7.Propozim vendim për financimin e projektit KH,,Drenica" (M)**
**FLUTURA AVDIU**-ne drejtoria për Kultur ,rini dhe sport edhe këtë vit kemi filluar më subvencionimin e klubeve, shuma që ka kaluar 1500 euro, kemi vendos që ti kalojmë përmes kuvendit,po e potencoj rastin e feronikelit ne e

kemi subvencionu klubin feronikeli me 30.000 euro propozimi vendimi është të kryetari, mirëpo për shkak të raportit jo bindes të klubit feronikeli, dhe për shkak të mos arsytimit të duhet se si i kanë nda subvencionet në vitin e kaluar ne kemi vendos që deri sa të na kthehet raporti kthyes i ketij klubi të mos i subvencionojm ne vler prej30.000 euro ,gjitha klubet tjera i kanë sjelle raportet kthyese

**SABRIJE KUKAJ**-shumat të cilat janë nda për perkrahjen e klubeve sportive janë minimale,edhe ne komitet për Politik dhe Financa kamë kerku që të rritet kjo shumë e subvencioneve dhe une propozoj që të rriten keto shuma pasi që vetem nje her po ju japim

**SOKOL BYLYKBASHI**-kemi para vetes disa propozim vendime per përkrahjen e klubeve sportive të cilat duhet më i perkrah edhe ma fuqishem,kisha dasht më pyet se përveq ketyre klubeve a ka ndonje kërkes të ndonje klubi për subvencionim,nese ka kërkes atëher është mir me i perkrah edhe ata më shumë simbolike

**XHAVIT DRENORI**-neve kuvendit po na mungon nje mekanizem i cili do të na kishte servu informacione më të hollsishme rreth kerkesave reale, te klubeve prandaj une ja beje propozim kryetarit, e di që është mandat i shkurter por është jashtzakonisht e rendesishme që ne ne kuved me pase komisione konsultative për secilen lemi dhe ai komision neve si anëtar të kuvendit sot na kishte këshillu ,sot është vetem pazari jo po ja japim 2.000 jo 2.500 une nuk e di se sa kane nevoj, une nuk kamë pa kerkese as raport se sa kanë hargju ne vitin e kaluar për mendimin tim ,ky debat është i të kaluares është dasht të jetë i së ardhmës,z.kryetar une e kamë ber nje punim shkencor për punen ekuvendit në drenas, ne krahasim më nje komune ne gjermani 174 aktivitete i bëjne anëtaret e kuvendit, ndersa në kuvendin komunal 38, të dy partë zgjedhen prej qytetarve për më i perfaqësu qytetaret,ne duhet ta kalojm këtë barjere që me e pa kuvendin komunal hajt vetem sa me i kalu vendimet por ti angazhojm këta njerëz ,kishe me qen me mir sot sikur të na kishe ardh nje informacion prej kolegeve që kishe qenë në atë komision dhe në kishte sjell nje raport dhe ne bazë të atij raporti kishim marre vendim, jo pse kryetari po thot me ja nda 2.000 aj tjetri 2.500 ky është pazarë ,ne nuk jema ardh më ber pazarë ne jemi ardhë mbi bazën e argumenteve me e marr nje vendim

**NEXHMEDIN BALAJ**-jo rastesisht e pyeta per shumen e pergjithshme për subvencionimin e kliubeve ,por kjo është 20% e asje që ne si kuvend ekemi pa të arsyshme që të jete ne buxhetin e vitit 2017 ,ne e kemi rreziku komplet buxhetin komunal pikerisht për keto subvencione duke kerku limitin, për ndihem ketyre klubeve sportive ne drenas,xhaviti thotë së është ndarje pazaresh ndoshta ai i doket por në ato klube janë nje mori njerezish që bejne pune vullnetare,kemi kerku rritje te subvencioneve vetem për ti stimulu klubet sportive, sepse po na bejen të ndihemi krenar ,pra ky nenqmim qëpo i behet sportit nga drejtoresha e kultures rinis dhe sportit është i pa kapërcyshem për mu, dhe i pa perballushem thot më nje arsyetim se nuk kemi mjete ne si Drejtori kur mejtet i ka 101.000euro subvencione dhe kjo arrin me i nda vetem 22.000 euro, une po theme se kjo më dy këmbet është duke e shkel sportin, dhe mund ta quaj ndoshta antisportistja më e madhe e komunës së drenasit edhe pse e udheheqë kete drejtori ,me vjen keq që tja drejtoj keto fjel nje zonjes e cila a ka marre detyren dhe është e nje gjinis se kundert, po e ndiej veten keq te ja theme keto fjale por duke i parë keto propozime para vetes nuk po kamë qare pa i thene

**FLUTURA AVDIU**- I nderuari asambleist une nuk jamë kunder klubeve sportive përkundrazi gjithmon i percjell ndeshjet,lidhur me atë se sa kemi mjete buxhetore në jemi duke u mundu më i perfshi gjitha klubet jo si vitet e kaluara i kan nda 30.000 euro feronikelit ,ndersa rinia ka mbete pa perkrahje, ne po mundohemi të gjithë sketoret më i perfshi dhe mos me mbete pa subvencionim,se a kemi kerkesa tjera te klubeve kemi klubev të shahut,shigjetaris të gjitha keto i kemi subvencionu ne shumën prej 300- 500 euro mirëpo pa e kalu shumen 1500 euro, keto nuk muenden më ardh ne kuvend, keto janë më vendim te kryetarit ,shumen qe e kemi caktu nuk është që nuk kemi mjete buxhetore, por kemi vendos keshtu, nuk do të thotë që janë plane 12 mujore, ndoshta janë edhe 6 mujore, se kemi klube që e kanë paraqit planin vetem per 6 mujë derisa të arrime shume 101.000 euro, siq e kemi parapar ne planin vjetor

**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI** –z.Balaj akuzat që ja drejtuat drejtoreshës të kultures ,rinis dhe sportit janë të ulta,ju keni da si asamble 101.000 euro subvencione për sektron e kultures ,rinis dhe sportit pra nuk e kemi përcaktu shumen se cilit sektor me i dhene me shume, dhe cilit më pak ,ne kemi kërkesa të shumta të sektorit të rinis dhe te kultures për subvencione, dhe jemi ne muajin e tretë ,pra ne nuk do ta subvencionojm nje OJQ dy here ,por do ta financojmë nje here, po deri ne fund te vitit kemi më pas kerkesa, vetem kur i thua dikujt duhet më të ardh turp, për ndarje te subvencineve për sport, duhet më llogarit që sherbimet emergjente në komunen tone i keni nda vetem 8.000 euro ,12 shtëpi janë djeg nga kulmi deri ne temel zemra po me dhemb nga 200 ,300 ,400 ,e 500euro ja kemi nda,kemi studenta që kemi me ju dhene bursa ,kemi nje mori aktivitetesh ,e kemi diten e Çlirimit ,e kemi edhe feronikelin nuk e kemi perjashtu, pa raporte kthyese une nuk pranoj me qite nënshkrim, kur neser marr përgjegjsi para prokurorit, nese e keni bere herave tjera keni gabu ,une nuk gaboj ,pra shuma të cilen e kemi percaktu është shume te cilen e kemi mendu që i ploteson nevojat, se asnje OJQ nuk mundet më u kriju më mëndimin dhe kushtin që asamblea e drenasit ka me nda mjete, dhe me jav pagu rrogat,pra po i lexoj emrat se kush ka marr rroge nga feronikeli që i kemi nda subvencionet, që është ose zyrtar i komunës ,ose zyrtar i arsimit ,ose trajner si jane : Nexhmedin Balaj ,Milaim Istogu ,Ilir Demaku ,Isak Ismaili ,Besim Bytyqi ,Adem H.Hykolli ,Ramiz Dervishi et,j pra keta e kanë shkel rregullin elementar të shpenzimit te subvencionit, e mos flas për lojtart që ju kanë dhan nga dy apo tre kater rroga nga subvencionet ,nuk janë per rroga sapo e votuat nje rregullore, subvencionet janë që lojtarve më ju kriju kushtet ekipeve ,ekipeve të futbollit më ju ble paisjet sportive ,veshmbathejet,ushqimin ,trasportin por jo pagen ,subvencionet nuk janë per paga,asnjeri nuk e ngriti ketu qështjen që me thene se Feronikeli i ka marre 225.000 euro prej fifas , është klub i komunës nuk është privat prej viteve 74 e ka themelu komuna, dhe askush nuk mundet me e vjedh pronen e komunes ,mundet me uzurpo përkohosisht por jo më e vjedh, dhe nuk ështe mir se qka po flasim per feroniklin sot, se mundemi më e demtu ne FIFA, nuk je rrit vetem ti më sport edhe une jom kane futbollist me Rexhep Rexhepin, kamë luajtur edhe une i kamë dy djemt e mi dhe njeri prej tyre ja ka pru tanat kupat feroniklit, përjashtuim këtë të fundit edhe une e du sportin,prandaj llogaritin sherbimet publike për emergjencë i kemi nga 200 apo 300 euro i kemi nda ,është ardh nje autoklub drenasi ka korre suksese të jasht zakonshme ja kemi nda 200 euro, ëshët ardh dhe mi ka gjuajtur letrat ka thene nuk ti du keto,qka me ber une me i thënë

hajde se ti japi 10.000 euro ja më e qite propozim të ju e me thene jepja 10.000, se i ka lype 17.000 mije euro edhe kur i kamë thene une se a e llogarit se i kemi 12 shtepi të djegura, dha ja kamë nda nga 200 euro ,tha nuk me intereson mu për shtepi po me intereson per vete,i thash qu dil për jashta nuk mundei me banë hajgare ketu .

**NEXHMEDIN BALAJ**-une spo besoj që keto subvencione ndahen per rroga sepse feronikli vetem prej FIFES që i ka marre ,merr edhe prej federates te futbollit e drejta televizive 10.000 euro, në vit i ka sponzorat e vet si Altrde mujore 3apo 4 mijë euro ne mujë, arsya eshte qe ne si komune spo i subvencionojm as 10% ,me vjen keq që e kamë sulmu nje zonje edhe i kerkoj falje ne aspektin gjinor dhe kolegial, po nuk muj më fal kurr kete dam që po ja banë sportit të drenasit ,sa i perket shtepive të skamnorve edhe vitin e kaluar kan qene te ndare 30.000 eur por asnje cent nuk eshtë shpenzu.

**IDRIZ HYSENAJ**- shume vite perpara ne merremi më të njejtin problem dhe ne kete listen e kerkuesve të donacioneve nga komuna jone për qdo vit shkon duke u rrite,ne i kemi dy klube që jane publike eshte klubii feroniklit dhe klubi i hentbollit meshkuj keto te dyja ne i kemi obligim që ti financojm ,ndersa klubet tjera nuk kemi apsultikisht obligim tiperkrahum ,nexhmedinit më shume është ka i dhemb konflikti i interesit se sa që janë da keto mjete ,keto mjete nuk jane pak ,ne e aprovuam këtë rregullore subvencionim për kultur rini dhre sport dhe jane me pak se 15 aktivitete që do të subvencionohen prandaj une qdo her kamë qen kunder arysea është se kurr nje her nuk akne sjell raport.

**NEXHMEDIN BALAJ**-nese Idrizi thot që vetem klubet publike kanë më u subvencionu ateher eshte dasht të ceket edhe ne rregullore,është dasht më e potencu dhe ne kete rast nuk ke drejt me ja ndalu klubeve tjera sepse me shpallje publika ata ken të drejt me apliku

**ISTREF ELSHANI**-me heret xhaviti tha se nuk kemi asnje kerkes se ku po shkojn paret,une jom duke e pa qdo propozim vendim që është ardh është ardh me shuma të caktuara edhe sa ka pas mundesi drejtoria e kultures dhe është edhe arsyetimi ,perveq klubit te feronikelit që nuk e kemi tjera e kane ber nje arsyetim ,ndersa per feronikelin qe ke thene KPF-ca 30.000 është shume shume e vogel, nese kalojm ne perqindje të klubeve 370.000 sa i shkojne feroniklit aty i bjen nje 10%ne duhet te jemi krenar me feronikelin,une kamë propozim që 40.000 euro të ndahen per feronikelin

**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI** -225.000 euro i ka marre prej FIFAS, i bjen që 125.000 euro jane tjera ,a ti spjegoj subvencionet tjera kush i ka dhene edhe sa i ka dhene dhe e tejkalon pa para tona hiq pa i subvencionu,une nuk jame tuj mos i dhene subvencione por jamë tuj kerku raport kthyes ,pra pa raport kthyes dikush që i ka marrë 70.000 euro nga kjo asamble nuk mundet me i marr 30.000 euro apo 40.000 -50.000 euro dhe ne kemi mbledhjen tjeter dhe ne prill i subvencionojmë ,une nuk marre rekomandime nga auditoret pse kamë nda mjete subvencione pa raport kthyes ,une vetem raport kthyes po e lypi

**FATMIR DUGOLLI**-une mendoj që duhet ti shohim gjerat më gjersisht sepse kur e kemi nda buxhetin ne kemi nda shume mjete ne krahasim me sektoret tjera,ndoshta i kemi seleksionu disa drejtori ne ndarje te buxhetit ,që tri vite vazhdimisht kamë ber perpjekje që me u bere Ribotimi i veprave e Ymer Alushani ne rasten e sofres poetike asnjeher skam arrit sepse kemi nda mjete shumë per sport ,të shpendajm buxhetin ne menyr te barabart, dhe ju po keni

deshir që klubet po ushtrojn a e dini se nëper shkolla fillore as topa nuk kanë këte duhet ta dime

**LIMAN KRASNIQI**-kuvendi komunal ka obligim ligjor vetem ndaj klubeve të cilat i a kanë themelu dhe jane klube publike ,ndersa ndaj klubeve tjera ndahen mjete aq sa ka arsyeshmerin edhe mundesit financiare ,prandaj une kisha propozu që ti permbahemi propozim vendimeve të KPF-ca tuj i konsideru se ata i kanë analizu edhe arsyetimet e gjitha klubeve edhe mundesit financiare ,mu me vejn keq, paraqes haptaz se që disa vite shumica e bizineseve kemi ndihmu periudhave kur ka pasur folklor ne drenas, shkaku i pa mundesis që kuvendi ka dhene mjete për ato,keshtu që të aprovojmë keto propozim vendime, dhe të lame mundesi financimi edhe aktivitetet tjera në nivel te drejtorisë se kultures.

**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI** –zyra ligjore e ministris se administrimit te pushtetit lokal ,kur une jamë kryetar i komunës thot se nuk kanë pru raport kthyes nuk e jep ligjshmerin mos i merrni ne qaf edhe ekpiet tjera , ne prill e subvencionojm feronikelin

**LIMAN KRASNIQI**-te une nuk ka propozim vendim per feroniklin ,une po flas ne bazë të dokumentacionit zyrtar që na ka ardhe ne kohe ,keta qe flasin per propozim vendimet që mendojn me i pru masandej ,une po flas per propozimet që kan kalu ne komitet per politik dhe financa

**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI** –une kam kerku që mos me marr vendim KPF-ca, për me nda mjete kesaj radhe feroniklit ,keta e kanë shti si propozim, se une ju kamë thanë se ne e kemi parapa që 30.000 euro por nuk e kanë pru raportin kthyes ,une nuk marrë verejtje prej auditorit të pergjithshem prej gabimeve te klubit futbiollistik feronikli ose përshkak të raportit jo te drejt ne aspektin e shpenzimeve të subvencioneve,une nuk e kamë pru atë propozim vendim dhe jam konsultu më zyren ligjore ,dhe zyra ligjore nese merrni vendim paket duke e shti edhe feroniklin ju garantoj që e kthen negativ për gjitha ekpiet ,po ju kerkoj me mirsi që kerkesen për feronikel ta kalojm në muajin tjeter jo që ja ndajmë 30.000 mije po i shofim kerkesat edhe ja ndajme 50.000mijë euro ,uroj që te behet kampijon dhe të del ne arenen nderkombetare, ti votojm keto propozime dhe pastaj ne mbledhjen tjeter ta kemi edhe propozim vendimin per feronikel.

**BUJAR THAQI**-që ne parim jemi per më i subvencionu klubet sidomos jashta mundesive ,une jam shume i sigurt se me na pyet se cilin ja kishim nga nga 50der 100.000 euro secilit por kjo eshte mundeisa ,por nje gja duhet me pas parasysh per klubin e feronikelit, eshte edhe kampion dhe pasi që jemi ne fund kishte qen me mir me qene nje shume me e madhe se 30.000 mijë euro, ndoshta janë pak mirëpo arsyetimin po e dime se nuk eshte ardh raporti qysh duhet ardh

**IMER DELIU**-une kame nje pyetje per drejtorin e kultures ne para vetes kemi 9 propozim vendime qe une personalisht gjitha i perkrahu sepse jame sportdash ,nga keto9 propozim vendime ,sa nga keto klube kane pru raport kthyse nese po a kishi pase mundesi me na pais edhe ne me ato raporte

**FLUTURA AVDIU**-po i nderuar ,ketu ne folder gjenden raportet e te gjithav klubeve për vitit te kaluar 2016 ,i kane arsytimin e mjeteve se ku kanë shku ato mjete

**IMER DELUI**-une kisha kerku që ne mbledhjen e radhes me na ardh me materjal për te gjitha klubet raportet kthyese

**SHQIPE ZOGU**-une kisha pasur nje pyetje konkrete për drejtorin ne fjale ,në bazë të cilave parime ligjore neve si asamble na u pamundesohet më i nda mjetet subvencion për kete klub përshkak të mos kthimit të rapotit kthyes, a është ndonje dispozit decitive ndonje rregullore që më të vertet neve na u pamundesohet ndarjen,se me sa une kame njohuri ndarja e mjeteve nga ana e asmblesë edhe ekzekutimi i tyre ne llogari bankare janë qeshtje të ndryshme njera me tjetren ,e dyta që po du me fole është për klubin futbollistik gryka me sa kamë njohuri ky klub nuk ka qene perfitues i subvencionneve vitin e kaluar është klub që është ne ligen e dyte ,gjithë lojtaret ne kete klub janë nga drenasi dhe mosha mesatare e lojtarve ne kete klub është 20 vjet dhe ky klub shpenzimet ne vit i ka 30.555dhe une propozoj që këtij klubi që shuma prej 2.000 euro të ndahet ne 5.000 euro pasi që janë edhe mundesit

**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI** –shqipe une me dasht përgjigjna për gjithë drejtorat ,edhe drejtoresha ta jep pergjigjen por une mundem me u pergjigj se une e jap nenshkrimin i fundit ,askush nuk ka të drejt më ja marr të drejten asmbles më e marr nje vendim ,a doni me e marr vendimin i cili duhet të egzekutohet a doni me marr vendimin të cilin doni mem qite mu gaf dhe mos me u egzekutu vendimi dhe ju me then që ne e kemi marr vendimin po kryetari spo ju a jep paret ,pra auditori i pergjithshem ka dhene rekomandim për ato OJQ se duhet me pas raport kthyes nje OJQ kur merr nje her ,pra feronikli ka marr ne 2016 duhet me bere raportin kthyes dhe raporti kthyes duhet me qëne me patim me rregullat dhe jo me dhene rroga se i ka dhene krejt rroga njeher 15.000 mije edhe njeher 30.000 euro ,nuk mi keni kerku dhe nuk i kemi sjell ,jane raorte që i sheh auditori, i doni keto raporte mbas mbledhje të gjithë nja nga nje mundeni me i pa ,nuk po them se gjitha raportet jane kanë perfekt por Handikos e ka perfekt pa asnje gabim por disa i kanë ashtu siq kërkohet subvencion, dikush ka dhene ndonje meditje, feronikli ne vitin e kaluar ka marre 70.000 eruo subvencion edhe per ata po kerkoj raport kthyes.

**SHQIPE ZOGU**-ne parim neve si asamble nuk na mohohet ndarja e subvencioneve për kete klub ,ne kemi te drejt sot të ndajm subvencione për feroniklin. mirëpo egzekutushmeria e tyre mjeteve nuk behet deri sa ata e sjellin raportin kthyes siq po pretendohet nga ana e egzekutivit edhe me shumë drejt

**KRYETARI I KOMUNES-RAMIZ LLADROVCI**-shqipe mundesh me propozu 50.000euro qetash edhe me e votu edhe une thom po ,por pa raport kthyes siq kerkohet nuk ka nevoj që kryetari me e ekzekutu

**ISTREF ELSHANI**- nese nuk hyne feronikli ne kete mbledhe kerkoj që te gjitha propozim vendimet per subvencione te shtyhen per një mbledhje tjeter e jo te votohet nje sot dhe nje mbledhjen tjeter

**SABRIJE KUKAJ**-une kamë propozim që edhe klubit kerkoj per klubin e hendbollit "Drenica"te rritet vlera ne 10.000 mijë euro dhe klubit gryke ne 5.000

**BUJAR THAQI**-kryetari nuk kish me qen keqe ne ne ti votojm e ateher egzekutimi i mjeteve i klubit feronikelit mos ti behet deri sa të ta sjell raportin kthyes

**HAKA TAHIRAJ** –propozoj që klubit gryka (f)ti ndahen 5.000euro

**SHQIPE ZOGU**- Propozimet nga Grupi Parlamentar i PDK-së

1. Propozim vendim për financimin e projektit KH,,Drenica" (M) 7.000
2. Propozim vendim për financimin e projektit FC,,Feniksi" 3.000
3. Propozim vendim për financimin e projektit KV ,,Gryka" (F) 2.000

4. Propozim vendim për financimin e projektit SHKA ,,Shotë Galica"5.0000
5. Propozim vendim për financimin e projektit KV,, Drenasi " (F) 2.000
6. Propozim vendim për financimin e projektit KF,, Qryka" 4.000
7. Propozim vendim për financimin e projektit Klubi i Boksit ,,Drenasi" 1.6000
8. .Propozim vendim për financimin e projektit KH ,,Drenica" (F) 1.6000
9. Propozim vendim për financimin e projektit KF"Feronikeli" 50.000
10. Propozim vendim për financimin e projektit KV,,Drenasi"(M) 1.510
11. Propozim vendim për financimin e Këshillit Lokal të Veprimit Rinor 3.000

**NAIM BAZAJ**-nuk mundesh shqipe mu thirrë në emer të grupit parlamentar të PDK-së as ti e as Idrizi se i keni pas vetem 5 vete,shumica kenë në sallë

**IDRIZ HYSENAJ**-gjith janë ftu,gjith janë konsultu,Naim je kryesues mos u perzi ti ,ti the se nuk je me pjes e Grupit parlamentar pse po perzihesh

**NAIM BAZAJ**- ne e thrrasim nje mbledhje edhe e mbajm grupi parlamentar a do të jesh ti idri a po nuk do të jesh

**IDRIZ HYSENAJ**-nuk është pronblem ajo ,ne per sot po flasim

**NAIM BAZAJ** –une po ju then se ne emer te grupit shumica apsolute ka qene në sallë kështu që nuk të kan ardh hiq

**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI**–a vin a nuk vine nuk ka rendesi kjo ,kryetari i grupit parlamentar i ka mbledh edhe kane vendos

**IDRIZ HYSENAJ**-qite ne votim propzimet egrupit parlamentar ,ti nuk je me na msu ti je më qite ne votim ose jo gjith kent te ftuar dhe me gjith u konsultova ka nrin ne sall ajo eshte problem i joni jo i yti

**NAIM BAZAJ** –une propozimin e grupit parlamentar e qes por askush nuk ka mujt mefol se shumiva kete ketu ne salle nese me lejohet me e vazhdu mbledhjen mir nese nuk me lejohet te premten vazhdojm me mbeldhje

Kryeatari –nuk te lejohet qka dush me ban o naim se ketu nuk e ke basht ta babes me ber qka te duash ti i ke propozimet dhe ti kryesues je

**NAIM BAZAJ**- as une e as ti nuk ekemi bashq te babes edhe une ketu jam ma i nalt se ti

**NAIM BAZAJ** –kërkonj që mbledhja vazhdon të premten prej ores:14;00

**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI** –nuk mundesh më e mbylle mbledhjen pa votim se te zevendeson tjetri ,qite ne votim per me e mbyll mbledhjen dhe ta votojn ti e ke kry por s eke kry kjo nuk ësjtë kështyu,nese të ka ardhe meriz ty per Xhavitin skom qka me bonë

**NAIM BAZAJ**-perqka per Xhavitin

**SHQIPE ZOGU** -kryesues proceduralisht edhe nderprerja e edhe pauza hedhen ne votim

**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI**-kush eshte anetari me i vjeter pasi që kemi korum askund ne bot nuk ka me e perfundu mbledhjen pa votim

**JETULLAH NISHORI**- si anëtari më i vjeter i kuvendit mori krysimin e kësaj mbledhje dhe kerkoj nga anëtaret e kuvendit që mbledhja të vazhdoj

**IDRIZ HYSENAJ**-jemi ne pyetje rreth subvencioneve të klubeve për mos më i vonu ne e votojm e qesim kete propozime ne votim dhe tjerat pika mundemi më i vazhdu ose me e nderpre mbledhjen ,pasi që e kemi shterr diskutimin rreth kesaj pike te rendit te dites e mira ka qene më e qite ne votim që jemi dhe per tjera e shqyrtojm a me vazhdu ajo

**BUJAR THAQI** prezenca e ketyre kolegeve jep e kuptu që 90% dojne me vazhdu seancen ,mirëpo ketu s edi sa jane kushtet e mira per me e vazhdu se nje pjes jane duke ndej as andej a as kendej

**SOKOL BYLYKBASHI**-une mendoj qe ferkimet e kryetarit dhe kryesuesi na prunen ne kete situat që të humb edhe vullneti për pune dhe nuk ka atmosfer te punes edhe kryetari është mir me pas kujdes me shume se eshte i pari i komunes edhe i ekzekutivit dhe nuk eshte mir me u sjell me nje arroganc jo vetem kryetari po gjith PDK-ja

**KRYETARI I KOMUNES-RAMIZ LLADROVCI**-faleminderit që po ma adreson mu por nuk ka pas asgje ndermjet meje dhe Naimit dhe as nuk ka ,qajo trimnia që e permende Sokol nuk është qyshtu qysh po del qetash ti ,Une po du me sqaru per qytetaret se nuk pati anje problem asnje ferkim ndermjet meje dhe Naimit ,ne rast se Naimi e tha disa pika më larg që nuk jame ma anëtar i Grupit parlamentar të PDK-së ai e solli kete situat jo une,une si kryetar i komunes deshta me i ndihmu mikut tim ,shokut tim nese don me e mbyll mbledhje me procedura ,pra me e qite ne votim per nje dit tjeter dhe me votim me e mbyll ,pra me i vjetri kerkon më e mbyll mbledhjen me votim .

**JETULLAH NISHORI**- kerkoj nga anetaret e kuvendit që kjo mledhje e rregullt te vazhdoj të premten prej ores 10:00 për të cilen u pajtuan të gjitn anëtarët prezent që ishin ne salle

VAZHDIMI I MBLEDHJES TË DATËS 29.03.2017,ME datë 31.03.2017 duke filluar nga ora 14:00

**NAIM BAZAJ**-fillimisht po ju njoftoj se une kamë deklaru se nuk jamë pjes e grupit parlamentar të PDK-së me tre (3) anëtarë

**IDRIZ HYSENAJ**- ti i ke thirrë ne telefon anëtaret e kuvendit;grupit parlamentar dhe ju ke thëne mos me marrë pjes ne mbeldhje

**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI** –Mbledhja,sipas Rregullores së punës,nuk ndërpritet pa bazë ligjore,as pa argumente të parapara në Rregullore.

Shkeljen e rregullores duhet ta sanksionoj dhe ndaloj Kryesuesi i Asamblesë e jo kryesuesi të jetë shkelësi kryesor i saj.

Kërkoj nga zyrtarët e komunës që të na sjellin krejt incizimin e seancës dhe me gjakftohtësi të analizojmë rrjedhën e seannës.

Kryesuesi i Asamblesë ka detyrime edhe ndaj asamblistëve edhe ndaj Kryetarit të komunës që në pajtim me rregulloren edhe të komunikojë,edhe të jap fjalën,edhe të përfundoj procesin e votimit për çështjet ngritura.

Madje,edhe për mbylljen e seancës,kërkohet votim.

Unë,nuk e kam shkelur Rregulloren e Asamblesë komunale por vetë kam ushtruar kompetencën time,për të mbrojtur interesin publik dhe interesin e qytetarëve të komunës.

**NAIM BAZAJ**-e njoftoj Kryetarin dhe anëtaret e kuvendit se me rregulloren e punës së kuvendit neni 9 i kesaj rregullorje e pecakton shumë mir se kushe udheheq mbeldhjen dhe kush ka të drejt ta nderpres mbledhjen ,gjithashtu edhe me ligjin për vetqeverisje lokale percaktohet se kush i thrret mbledhjet e kuvendit dhe kush i udheheq,pra une jame kryesues i kuvendit dhe e kamë kët të drejt ligjiore

**XHAVIT DRENORI**- lexoj deklaraten para anëharve të kuvendit ku e kishte dorzuar edhe me shkrim se nga dita e sotme nuk do të jemë më pjes e grupit parlamentar të PDK-së por jamë kandidat i panvarur se ju e dini se unë kam një grup që quhet vizioni për Drenasin, dhe kjo është asryeja që po jap dorëheqje, absolutisht nuk ka të bëjë me ndërprerjen e mbledhjës, por sa i përkët mbledhjës që është nderpreë kryesuesi është dasht që ta hedhë në votim se a me vazhdu mbledhja apo jo.

**ISTREF ELSHANI**- Tha Idrizi më heret se Naimi i ka thirr në telefon që te mos vijn në mbledhje të grupit parlamentar të PDK-së, por nuk është e vertetë ajo dhe mendimin tim nuk mund të ma dirigjon askush as në të majt as në të djatht sepse unë kam parimet e mija.
**BUJAR THAQI**- Parafolësi më heret deklaroi se nuk po ka hapësir të mjaftueshme të punohet në grupit parlamentar të PDK-së kur kryetari Lladrovci se bashku me ish drejtorin e urbanizmit Betim Berisha i kanë ofruar pozitën e drejtorit për drejtorinë në fjal e ka pranu, ka qitë drek per këtë punë, e falenderojmë për drek po ska pas guxim me marrë kta duhët me cek që nuk është e vertet që nuk i kena dhanë hapësir, ka qënë ndër pak njërëzit brenda territorit të komunës së drenasit që ka pas atë mundësi me udhëheq drejtorin e urbanizmit por nuk ka guxim me e marrë këtë pergjegjësi.
**XHAVIT DRENORI**- Nuk e përmënda emrin e kryetarit që nuk më është ofru hapësir atë e dini edhe ju është edhe medialisht unë thash grupin parlamentar nuk e udhëheqë kryatari absolutishtë nuk ka lidhje me të, grupin parlamentar e udhëheq zoti Idriz Hyseni me gjith anëtaret e kuvendit, nërsa sa i përkët Drejtorisë së urbanizmit ua bëjë një sqarim pak më vonë.
**IDRIZ HYSENAJ**- Nuk kisha pas dëshir me i lodh antarët e kuvendit me problemet qe kemi brenda grupit parlamentar, që pjesë e atyre problemeve kryesisht është Naimi kryesuesi i Kuvendit, po njëkohësisht edhe ty Istref nuk ka pas nevojë met thirr se ke qënë bashk me ta, kshtuqë ata që nuk kan qënë bashk me Naimin i ka thirr edhe ju ka thënë mos shkoni për mos me ban kuorumin.
**NAIM BAZAJ**-ju drejtua Idrizit dhe i tha se vetem 5 vete i ke pasur pjesmarrës ne Grupin parlamentar të PDK-së gjithsejt janë 23,se Jetullah Nishori nuk ka qene anëtar i PDK-së se ai tek në e ka dorzuar me shkrim se është kandidat i panvarur
**JETULLAH NISHORI**- prej që kanë filluar zgjedhjet për Kryetar une kamë punuar për Partin Demokratike të Kosove por edhe jamë kryetar i seksionit të PDK-së në Komoran
**NAIM BAZAJ**- po ti vetë me shkrim je deklaruar se je i panvarur
**JETULLAH NISHORI**- po mir,une po deklaroj edhe publikisht se jamë pjes e Grupit Parlamentar të PDK-së
**IDRIZ HYSENAJ**-problemet e medhaja je kah i sjell ti Naim dhe vetë je deklaru publikisht se nuk i takon grupit parlamentar të PDK-së
**NAIM BAZAJ**-perqares kryesor jeni ju Idriz që po e perqani grupin parlamentar
**SOKOL BYLYKBASHI**-kamë pyetje për kryetarin dhe kryesuesin
**NAIM BAZAJ**- vazhdojm më piken e 7 të rendit të dites
**IDRIZ HYSENAJ**-kerkoj që të hidhet në votim propozimi i grupit parlamentar të PDK-së -duhet të mirren per bazë edhe propozimet tona jo vetëm të grupit parlamentar të pdk-së
**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI** –grupi parlamentar i PDK-së i ka të gatshme propozimet le të hedhen në votim
**XHAVIT DRENORI**-nëse nuk na lejohet edhe ne ti bëjmë propozimet tona kjo është shkelje dhe nuk lejohet
**LIMAN KRASNIQI**-le të merren fillimisht propozimet e KPF-ca ,e pastaj edhe propozimet e grupit parlamentar të pdk-së dhe te opozites
**SOKOL BYLYKBASHI**-unë kerkoj që per nja 5 minuta apo 10 te pushojmë ti pergadisim propozimet edhe opozita dhe i paraqesim kuvendit.

**NAIM BAZAJ**-pas pushimit kerkoj nga gupi parlamentar i pdksë ti japë propozimet:
Propozimet e Shqipe Zogu nga Grupi Parlamentar i PDK-së
12.Propozim vendim për financimin e projektit KH,,Drenica" (M) 7.000
13.Propozim vendim për financimin e projektit FC,,Feniksi" 3.000
14.Propozim vendim për financimin e projektit KV ,,Gryka" (F) 2.000
15.Propozim vendim për financimin e projektit SHKA ,,Shotë Galica"50000
16.Propozim vendim për financimin e projektit KV,, Drenasi " (F) 2.000
17.Propozim vendim për financimin e projektit KF,, Gryka" 5.000
18.Propozim vendim për financimin e projektit Klubi i Boksit ,,Drenasi" 16000
19..Propozim vendim për financimin e projektit KH ,,Drenica" (F) 16000
20.Propozim vendim për financimin e projektit KF"Feronikeli" 50.000
21.Propozim vendim për financimin e projektit KV,,Drenasi"(M) 1.510
22.Propozim vendim për financimin e Këshillit Lokal të Veprimit Rinor 5.000
NAIM BAZAJ -kerkojë nga opozita të japë propozimet e veta:
Propozimet e Vehbi Berisha nga Opozita
1Propozim vendim për financimin e projektit KH,,Drenica" (M) 8.000
2.Propozim vendim për financimin e projektit FC,,Feniksi" 5.000
3. Propozim vendim për financimin e projektit KV ,,Gryka" (F) 5.000
4.Propozim vendim për financimin e projektit SHKA ,,Shotë Galica"4.0000
5.Propozim vendim për financimin e projektit KV,, Drenasi " (F) 5.000
6.Propozim vendim për financimin e projektit KF,, Gryka" 4.000
7.Propozim vendim për financimin e projektit Klubi i Boksit ,,Drenasi" 2.5000
8.Propozim vendim për financimin e projektit KH ,,Drenica" (F) 2.500
9.Propozim vendim për financimin e projektit KF"Feronikeli" 40.000
10.Propozim vendim për financimin e projektit KV,,Drenasi"(M) 2.500
11.Propozim vendim për financimin e Këshillit Lokal të Veprimit Rinor 5.000
Pati edhe disa propozime shtesësi:
Klubi i shahut-500euro
Shoqëria Kulturore Ymer Alushani 1000 euro
Shigjetarin -1600 mijë euro
Titujt e librave-1000mijë euro
**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI** -disa kerkesa e shoh se janë qesharake,por ne kemi propozu aq sa kemi mundësi ,ne nuk e kemi veq sportin me financu është edhe sektori i rinisë dhe ai i kultures e aktivitete tjera si kemi diten e qlirimit të drenasit qe ne duhet të kemi mjete për këtë qëllim.
**NAIM BAZAJ**-hodhi në votim propozimet e dhëna nga Grupi parlametar i PDK-së të gjtiha propozimet per financimin e sportit si:
Me rastin e votimit prezent ishin 28 anëtar
Rezultati i votimit ishte si vijon:
Për:24
Kunder:02
Abstenim:02
**NAIM BAZAJ**-hapi diskutimin për piken e shtatëmbedhjet të rendit të dites
**17.Propozim - Rregullore për përcaktimin e kritereve dhe procedurës për dhënien me qira të banesave në pronësi të Komunës**
**SOKOL BYLYKBASHI**-neni 2 që nuk kanë shpi apo banesë(ka të varfer),ketu ka të bëjë me dy kategori dy zgjidhje per perfitim financiar,dhe të dyten perfitues të shtresës sociale,unë jamë për këtë të dyten,(të gjithë ata që nuk kanë kulm mbi

kokë),me një kontratë simbolike ,por disa uzurpator duhet me i liru ato banesa ,njeri nder këta uzurpues është vetë kryetari i grupit parlamentar të pdk-së

**IDRIZ HYSENAJ**-mos hedhë balt ti ,qka ke ba ti per këtë shtet kurgja ske ba,unë ketij shteti vetëm të mira i kum sjell ,paguaj tatim mbi 100mijë euro kamë të punësuar 40 punëtor veq te mira i kamë sjell komunës kurrë nuk kamë perfitu nga komuna unë nuk e këmë firmen sot që 27 vite punoj n5 vite burg i kamë mbajtur,kontributin e kamë dhënë edhe gjatë luftes e mos banë shpifje,e sa i perket ketyre banesave me u pas vetë unë ketu banesa është dashtë të shiten dhe i kishin sjell vetëm të mira kishim pasë mundësi me i marrë mbi 1milion e 500mijëeuro,keto banesa nuk janë sociale keto janë banesa profitabile,

**SOKOL BYLYKBASHI**-ne jemi familje që kemi dhanë kontribut gjenerat mas gjenerate e dinë të gjithë kush ka qenë familja jonë,shpija jonë ka pasë komandant në luftat e mehershme,dhe deklaroj se ne vimë në pushtet atëherë ju kallxojmë ne vendin ju venin e keni në burg.

**SHQIPE ZOGU**- Në parim i përgëzoj hartuesit e kësaj rregulloreje, më vjen mirë qe ka ardhë në votim një rregullore e till dhe shpresoj se më në fund do të zgjidhet qështja e banesave të cilat janë të pashfrtytëzuara, unë përsonalishtë i kamë disa ndryshime nese veq kishin mundë me i marr sekretaria edhe pastaj me u hedhë në votim, është fjala te neni 2 ku thuhet e drejta për perfitim të banesave me qira, në këtë rast ktu është si lloj kategori janë të përcaktume domëthënë janë familjarë individ e kshtu me radhë, unë kisha propozu që si kategori të hyjnë edhe viktimat e dhunës në familje të cilat pas përfundimit të procesit gjygjësor nuk kanë strehim dhe shkojnë në strehimore të Prishtinës.Tek neni 8 te shpallja publike pika e 9 është e drejta për ankesë dhe është shumë mirë që është e parapame për këtë nen, por propozojë që të shtohet edhe afati kohor që ne qfar afati të caktuar ka të drejtë të bëjë ankesë ai që e parashtron ankësën, tek neni 11 dokumentacioni i nevojshëm për aplikim pika 1 nënpika 7 ku kërkohën dokumentet për transaksione të shitëblerjes së prones së paluajtshmë përkatsisht banes ose shtëpi dokumëntet kërkohën vetem tek njeri bashkëshort kështu që propozojë që aplikuesit ti kërkohët deshmija edhe për bashkëshortën përkatësisht bashkshortin se a ka pas ndonjë transaksion të këtij lloji, poashtu edhe te neni 13 detyrat e komisionit pika 1 nënpika 4 ku bëhët proces për gjendjen faktike kish qënë mirë me u cekë edhe gjendja faktike në terren, pastaj tek neni 20 kontrata e qiradhenies pika 2 propozoi që këtij neni ti shtohet edhe afati paralajmërues për shkëputjen e kontratës. Tek neni 28 pika 1 kur qiramarrësi nuk banon në banës pa arsye për 1 vit shkëputët kontrata unë propozoj që nga 1 vit të bëhët 6 muaj.

**IDRIZ HYSENAJ**-keto banesa duhet të jenë profitabile,se ne e kemi provuar edhe me dy rregullore te aprovuara më heret dhe nuk kemi pas sukses per atë kjo rregullore sot na mundëson që të bëjmë një zgjidhje

**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI**-në këtë rregullore janë percaktu kriteret dhe në këtë rregullore kanë punuar ekspert të kësaj lemie,

**NAIM BAZAJ**- te neni 16 të shtohet edhe një pikë që në kushte të barabarta të përfitojnë familjet e deshmorëve, viktimat civile të luftës, familjet e invalidëve të luftës si dhe familjet e veteraneve të luftës.

**LIMAN KRASNIQI**- në këtë rregullore neni 1 paragrafi 2 sipas meje duhet të hiqet por të shtohët pragrafi tjeter ku definohet lloji dhe prejardhja i banesave, kisha propozu të shtohet: banesat janë të perfituara nga dhënia e tokës në shfrytëzim në bazë të procedurës e cila është bërë në pajtim me dispozitat e

rregullores për dhënien afatgjate të pronës komunale në shfeytëzim domëthënë janë banesa që kan një prejardhje profitabile nuk mundemi me i trajtu si banesa sociale, qdo pronë e komunes e cila ipet në shfytëzim ipet me qellim që asaj prone ti shtohet vlera, pra kësaj prone ju ka shtu vlera ka ardh deri ne këtë shkall ku kuvendi komunal mundet me marrë vendim qe me i dhanë me qira domëthënë më këtë ti konsiderojm si banesa me prejardhje të rregullt e jo banesa sociale qe i kemi donacion e qe dikush ja ka fal komunes për me zgjidh probleme sociale. Te kreu i tret ku thuhet numrin e banesave qe janë në dispozicion per programe të veqanta të banimit neni 3.2 dhe tek neni 3.1 nuk ka nevoj programe te caktuara, i vetmi program qe mudemi me e destinu ni numer te caktuar prej këtyre banesave unë kisha propozu që të bëhët një kategorizim për kategorit e dalura nga lufta por jo tek të gjitha banesa përshëmbull kaq banesa për këtë kategori por jo si problem social por si individ që ka dhënë kontributin e vet, kurse tek neni 11 ku thuhet deshmija për gjeodezi ose kadaster qe posedon shtëpi ose banes, këto pasi që nuk janë banesa sociale nuk ka nevoj a ka apo nuk ka, me këto banesa ne duhet tja japim ati që paguan qira më të lart dhe i krijon të hyra kuvendit komunal edhe e zgjidh ni problem për qështje komunale që i nevojitet rrethit komunes apo kujtdo tjeter gjithashtu kisha kerku qe neni 1.4 të hiqet poashtu neni 1.5 deshmija nga drejtoria për financa dhe buxhet se a është i ngarkuar në tatim pronë aplikuesi, qka i intereson se a është i ngarkum apo jo kur ai zotria është i obliguar të paguaj qiran domëthënë të hiqet edhe ky nen. Edhe tek neni 7 ku thuhet se në 5 vitet e fundit aplikuesi nuk ka bërë transaksion blerje ose shitjes, edhe këtë kisha propozu me heq se ai që nuk shet e nuk blen ai nuk mundet me e pagu qiran neve na duhen njerez që punojn dhe paguajn qiran. Tek shkëputja dhe ndërprerja e kontratës, nuk ka kuptim që nje personi i cili e paguan qiran ti nderpritet kontrata pasi që këto banesa nuk janë banesa sociale, po e permendi edhe një herë neni 1 kisha propozu të hiqet ku thuhet kur qiramarrësi ose ndonjë anëtar i familjes bëhët pronar i ndonjë objekti të banimit, ai le ti këtë 10 objekte le ta kryn qiran për këtë banesë obligimi i kuvendit është ai, neni 1.2 nese konstatohet qe ka qene pronar i ndonjë objekti të banimit edhe këtu 100 objekte le ti ketë vetem le ta paguaj qiran, komunës i intereson profiti se edhe neni me të cilin jeni thirrë që është shumë me vend për këtë lloj banesav e përcakton shumë mirë. Neni 1.7 ku thuhet kur qiramrrësi e ka përmirsuar gjendjen ekonomike, sk të bëjë kjo me gjendjen ekonomike sepse këto nuk janë banesa sociale, ndërsa sa i përkët tabela e llogaritjes së kategorisë përkatësë është komplet e papërshtatshme për llojin e banesav për të cilat ne sot vendosim rregullore domëthënë kisha kerku që kjo tabelë të hiqet komplet të konsiderohen si banesa me prejardhje të cilën e percaktova dhe të konsiderohen me një fjal të thjeshtë banesa që i jep kuvendi komunal më qëllim të përfitimit të një qiraje edhe është mirë të caktohet nje nivel i qirasë që nen atë nivel mos me shku kurse ai që jep vler më të madhe të qirasë ati ti ipet prona në shfrytëzim dhe të krijohen të hyra për kuvendin komunal dhe bugjetin e komunës.

**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI**-Liman e perserita edhe një herë po e perseris prapë, ne nuk po flasim për një propozim rregullore për banesa sociale që social nuk paguan qiramarrësi dhe nuk po flasim që ne po i nxjerrim në shpalje publike banesat se kush paguan më shtrënjt, pra nese është ashtu këto banesa i marin biznismenet, këto banesa janë pronë e komunës në shërbim të atyre që kanë nevojë më së shumti por që nuk janë kategori sociale,

pra këto banesa nuk janë as për kategori biznismenave por as për katëgori sociale domethënë janë banesa për plotsimin e kritereve për dhëniën me qira atyre që potësojnë këto kritere.
**XHAVIT DRENORI**-unë jamë i knaqur që ka ardhë një dokument perpara nesh,sepse keto banesa ka vite që keqperdoren dhe janë te uzurpuara edhe nga vetë zyrtarë apo të aferm te tyre,edhe unë jamë për atë që banesat të ipen me qmimin me të lartë që e ofron dikush ,dhe me ato mjet kemi mundësi me i subvencionu familjet që kanë nevojë e që ka shumë prej tyre që janë në gjendje të rënd sociale,ne duhet të mësohemi dhe të integrohemi se keto nuk janë banesa sociale per të strehuar por janë banesa që komuna duhet të perfitoj.
**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI**-ma mirë është të japni propozime konkrete,e jo të diskutoni kot,ne ketu banesa mundë ti qesim edhe në shitje, por këto banesa nuk janë sociale pasi që nuk i përfitojnë ata që janë me gjendje sociale pra nuk mundesh me shku me vertetim të socialit me thënë ma jepni mua banesen e socialit, unë jam dakord në qoftë se kuvendi vendosë me i shitë këto prona edhe mi kthy të mirën e sherbimit publik. Poashtu unë kam pergaditur material për mbledhjen e ardhshme për të gjitha pronat e uzurpuara ku dikush më ka kritiku mua qe po ua pengoj ato lokale që kanë ndërtuar në pronë publike, për këtë qështje kam krijuar komision yë cilët kanë dal dhe kanë bërë matje unë do ti thërras të gjith pronaret dukë ju dhënë oferta nese duan të paguajn shumën e caktuar pastaj nese ata pajtohen unë e fus në rregullore për ta miratuar asambleja ne rast se nuk pajtohën do tua japë një afat të caktuar për ti kthyer në gjendjen paraprake poashtu nese kjo nuk ndodh do të mirren masat e nevojshme.
**XHAVIT DRENORI**-propozimi im ishte që keto banesa të ipen me qira kush të ofron qmimin më të lartë ,më qellim që komuna te perfitoj nga këto banesa mirpo me gjasë ky propozim nuk i pelqeu dikujt, si do që të jetë propozimi im është që te jipën këto banesa për përfitim të komunës dhe me rritjen e bugjetit ne kemi me pas mundësi më aloku për raste të ndryshme me ju ndihmu.
**SABRIJE KUKAJ**-keto janë banesa profitabile ,edhe unë jamë që keto banesa të ipen më qira kush ofron qmimin më të lartë më qëllim që të krijohen të hyra nga këto banesa
**NAIM BAZAJ**-unë kisha propozu të formohet një komision që ta hartoj një rregullore ashtu siq po kërkohet nga shumica e anëtarëve të kuvendit
**LIMAN KRASNIQI**-mirë ka qenë të shkojmë më propozime konkrete
**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI**-kerkoj që të shkohet dhe të votohet nen per nen,një nga një, se pari hudhet në votim propozimi që ka kalu pastaj propozimi i asambleisatëve pra ai që fiton shkon deri në fund dhe e përfundojmë.
**NEXHMEDIN BALAJ**-keto nuk janë banesa sociale,unë kisha kerku që edhe shumica e anëtarëve po kerkojnë që kjo rregullore të shtyhet per një mbledhje tjeter të perpunohet dhe kjo rregullore të jetë një rregullore profitabile
**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI**-ne nuk po flasim per uzurpime ,jemi duke fol per një rregullore që ka të bëjë per dhënjen e banesave pronë komunale per shfrytëzim me qira,ne jemi konsultu edhe me Ministrinë e planifikimit hapsinor ,nese nuk e votojmë rregulloren nen per nen dhe ne perputhshmeri me ligjin munde te na kthehet perseri ne kuvend
**LIMAN KRASNIQI**-perseri deklaroj se keto banesa duhet te trajtohen si banesa profitabile e jo të jenë të karakterit social, te mirren përbazë edhe rregullore të tjera unë i pashë në internet tek ministria e planifikimit hapësinor dihet se si i

ka trajtu llojin e këtyre banesave, pra po them se ndarja e banesave është qështjë e kuvendit dhe nësë bejmë ndonjë shkelje ligjore ne i kemi juristat e kuvendit ku mund të mirrën me ato qështje dhe pajtohem me propozimin e parafolësit pra të kthehet edhe një herë dhe të përpunohet, ajo që është më rëndësi kriteret e kësaj rregulloreje i përkasin rasteve sociale por ne nuk jemi duke zgjedhur raste sociale.

**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI**-Kjo rregullore askund nuk shkruan se kush është rastë social e merr banesen, rast social është kur dikush i merr 75 euro ndihma, nese doni me shty atëherë e hudhni në votim por nuk mundesh me e shty ni rregullore të cilën veq e kanë përpara asambleistat, këtë mundemi ose me e kundërshtu nese i ke votat ose me e votu pikë për pikë, pra këtu vendos vota e nuk vendos as Limani as Ramizi e as Idrizi.

**FATMIR DUGOLLI**-pajtohem më disa propozime që i dha Shqipja,dhe sa i perket kritereve duhet të permisohen,por duhet të parashihet edhe të vlersohet se qira marrësi a ka mundesi materjale me e pagu qiran apo jo

**VEHBI BERISHA**-Tek kjo rregullore kemi një konfuzion, për shkak se kemi paqartësi të mëdha sidomos te tabela e poenizimit, me hëtët e kalukuluam me Idrizin dhe qiraja mesatare ishte diku 100 euro, ky është një problem shum i madh pra parafolësit i përmëndën disa nene ku duhej të bëhëshin ndërhyrje, nese kishte qënë vetëm për një nen atëhëre e kishim heq por duhët të bëhën shum ndërhyrjë.

**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI**-Ju e keni llogarit atë por keni harruar të llogaritni sipas metrave katror, 1 familje që ka të ardhura 100 euro nuk aplikon për një banesë që ka 100 metra por aplikon për banesë që ka 50 ose 60 metra katrorë, ajo formula është vetëm për me gjet koeficientin sa ka me kushtu.

**XHAVIT DRENORI**-tuj i pasë parasysh diskutimet e gjithëve kolegeve une shih se kjo rregullore nuk do të funksionoj,po është nje thenje që në këtë rast po e citoj kur thuhet ne duhet të mësojm më e zënë peshkun e jo të japim peshkun e gatshëm se në këtë rast nuk duhet ti mesojm gjithëher vetem të ju ndihmojm dhe kjo rregullore ka nevoj për plotësime dhe ndryshime.

**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI**-Xhavit kjo rregullore ka ardhë në kuvend me u miratu me ndryshimet e juaja, pra ju sot keni mund me ndryshu rregulloren pikë për pikë, por për me i heq ata uzurpatorë pra për mos me vazhdu me u uzurpu këto banesa bëhët rregullorja, komisioni i përbërë nga 5 asambleistë dhe antarët e tjerë gjithsej 11 përsona nuk e di sakt sa janë por sipas kësaj rregulloreje largohet përgjegjësia nga kuvendi komunal i Drenasit.

**IDRIZ HYSENAJ**- gjith anëtaret kanë dhënë sygjerime të mira,kjo rregullore na ka ardhë ketu duhet të bëjm zgjidhje ashtu siq parashihet në afat 3 vjeqar,është nje formul që e ka percaktu vleren banesës dhe në bazë të kesaj formule është percaktu edhe vlera e baneses dhe ne duhet në këtë rast të bëjm zgjidhje ,rregullorja është që i percakton vleren ,une edhe më heret thash se nësë është qmimi më i lart në bazë të qmimit dhe ofertes kishim pasë mudesi të bejm zgjidhje

**NAIM BAZAJ** – hodhi në votim këtë pikë të rendit të dites më ndryshime që propozuan anëtaret e kuvendit

Me rastin e votimit prezent ishin 27 anëtarë

Rezultati i votimit ishtë si vijon:

Për:22

Kundër:03
Abstenim:02
**NAIM BAZAJ**- i njoftoj për planin e punës për vitin 2017
**18.Plani i punës për vitin 2017**
**XHAVIT DRENORI**-më vjëen mir që ka ardhë nje plan i till po jamë idhtar i asaj se si dhe ku janë bazu pikat që janë percakt për qdo mbledhje që do të mbahen
**NAIM BAZAJ**- nese nuk ka dikush tjeter të diskutoj për kete pik të rendit të dites kërkoj nga anëtaret e kuvendit se a pajtoheni më këtë plan të punes së kuvendit,pasi që nuk pati diskutime dhe verejtje në këtë rast u pajtuan të gjith anëtaret prezent
**NAIM BAZAJ**-hapi diskutimin për piken e tetëmbedhjetë të rendit të dites
**19.Raportet e Komiteteve Konsultative**
a)Raporti i Komiteti Konsultativ për Arsim,Kulturë,Rini e Sport
b)Raporti i Komiteti Konsultativ për Zhvillim Ekonomik.Mbrojtje të Ambientit Shëndetësi dhe Mirqënje Social
**SOKOL BYLYKBASHI**-përkrahu këtë raport,por pati vërejtje tek faqja 8 e keti rapörti se si nuk janë marrë per bazë rekomandimet e dhënë të keti komiteti as nga zyra e kryetarit e as nga zyra e kryesuesit,si dhe kërkoj që ketyre t'u mundesohet kërkesa për nje zyre për punë
**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI**-ju falenderoj për mbështetje,gjitha kërkesat do ti marrë per bazë,por ju drejtua Xhavitit dhe i tha se ta kamë dhënë rastin me u ber Drejtor dhe ti nuk ke guxu me e pranu,the se une e kamë shkarku Betim Berishen ai ka dhënë dorëheqja nuk e ke shkarku ti ,perkundrazi une e qmoj dhe e vlersoj betimin dhe e kamë nje bashkëpuntor të mir dhe i kamë ofru detyren e Nënkryetarit të Komunës une pres me e pranu këtë detyr e detyren e drejtorit vet e ka liru që ju me e marrë kete detyr dhe jeni deklaruar e edhe drek u ke dhënë se une do të jeme drejtor i urbanizmit
**XHAVIT DRENORI**-po është e vertet dhe une ju falenderoj për këtë,por nësë ju e lavderoni drejtorin e urbanizmit i cili drejtor nuk ka punuar asgje dhe gjitha projektet janë kryer pa asnje cilsi e keni gabim, nje drejtor i cili ju ka dhenë projekte duke filluar nga babai i tij shokeve dhe miqeve të tij , e lavderoni nje drejtor që 3 vite nuk e ka zgjedh qeshtjen e banesave për kete qëllim dhe pasi që është nje koh e shkurter dhe e kamë par së nuk kamë mundesi të të ndihmoj për këtë qëllim edhe nuk e kamë marr detyren e drejtorit të Urbanizmit,në vend që të shkarkoni këtë drejtor ju po e ngritni atë dhe po ju afroni detyren e nënkryetarit edhe kjo është njera nder arsyet që nuk e kamë pranuar këtë detyr
Po kthehemi në temë të Komitetet Konsultative të cilet e kryejn nje pune kanë dhën rekomandimet dhe sygjerimet e tyre në vend që të merren per bazë ato mbeten anash, por duhet ti kemi parasysh rekomandimet e tyre sepse ata si anëtarë të ketij komiteti paguhen ,por kamë nje pyetje Kryetar se a do të merreni për bazë keto ide dhe rekomandime të keti komitetit ,a i keni ftu apo do ti ftoni në takim këtë komitet dhe të keni qasje kjo më interesnon
**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI**-Betimi ka qen Drejtor i Urbanizmit,po ata që ti deklarove se ka marrë pune nga Komuna babai i tij kjo nuk qëndron sepse ai nuk ka firme fare
**XHAVIT DRENORI**-o Kryetar ka deshmi që edhe kanë vjedh gjat ralizimit të projekteve,por për qdo pune të mir që ju e beni une do të ju perkrahu,por në këtë rast kisha kërku që dy fusha ti mbuloni se e ke punën keq në drejtorin e Arsimti edhe të urbanizmit ,aty është ber krim ti e din më mir Kryetar, e sa i

perket punesimit edhe ju kryetar jeni duke i punesuar njerz familjar dhe njerz të politikes,dhe sot kemi një rast konkret ku nje person është me master dhe nuk ja keni pranu dokumentat që nuk i ka certifikaten e Ëord dhe Excel,sili i diplomuar në ekonomi nuk din ëord dhe exel

**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI**-më Betim Berishen une i kamë fituar zgjedhjet krah përkrah mbi 15 mije vota,dhe publikisht e falenderoj Betim Berishen që ma ka dhënë mbeshtetjen gjatë zgjedhjeve

**ARBEN NIKA** – doli në foltore dhe dha arsyetimin rreth Raportit per Zhvillim Ekonomik.Mbrojtje të Ambientit Shëndetësi dhe Mirqënje Social dhe në këtë rast përmendi të arriturat e keti komiteti si dhe idet që komuna i ka marr per bazë si: nxemja qëndrore për qytet nga ana e feronikeli,menagjimi i mbeturinave, projekti i shpenzimeve për vorrim, plani komunal për menagjimin e mbeturinave ,deponit si dhe ne planin lokal të veprimit dhe ne fund kekroj sipas mundesive komuna të sigurohet nje zyre për pune të keti komiteti

**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI**-ne do të perpiqemi që ketyre komiteteve do të sigurojm zyret ne ish objekin e komunes së vjeter

**VEHBI BERISHA**- falenderoj të dy komitetet per punën e tyre dhe kisha kekrou nga komitete që rekomandimet e dhene heren tjeter te vine ne forma tabelare

**NAIM BAZAJ**-hapi diskutimin për piken e njezetë të rendit të dites

**20.Plotësimi dhe zevendsimi me një antarë të K.P.F-ca**

**SOKOL BYLYKBASHI**-une e kamë per nje ankes qysh ne fillim të formimit të komitetit për politik dhe financa sepse qysh ne fillim është zgjdh ky komitet ne mënyr të jashtligjshëme dhe nuk kane qenë të perfshira anëtaret e opozites ne komitet sipas ligjit,ligji po shkilet ,ligji duhet të zbatohet,dhe perseri ka shkelje të ligjit dhe anëtari është zgjedh në menyr te kunder ligjshëm une e kam edhe më shkrim nga misnitria, që ma ka kthyer pergjigjjen pas kerkeses që e kamë ber ,por ne kete rast kërkoj nga kryetari dhe kryesyesi që të merren seriozisht më këtë se në të kundërten une do të vazhdoj më procedurat tjera ligjore që me lejon ligji dhe do të ngris aktakuz

**NAIM BAZAJ**-i njoftoj të pranishmit se e kemi nje shkres nga MAPL-ja që Rifat Bilalli mund të jete anëtar i keti komiteti por vetem duhet të permendet zëvëndesimi

**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI** – MAPL-ja letren e fundit e ka kthy se duhet të zgjidhet një anetar i asamblese prej të ciles ka shkuar anëtari i asamblesë,nese shkelet ajo rregullore ta garantoj që une kame me e percjell për vlersim ligjor

**SHQIPE ZOGU**- të pergjigjja e ankeses që ju eshte dhene z.Sokol Bylykbashit ,me sa e kuptova une aty është thenë qe është berë vetem shkelje e ligjit dhe nuk e specifikon se cila shkelje eshte bere ,keshtu që nuk mundesh më ngrit aktakuze aq të rendë pa e specifiku se cila shkelje është bere

**RIFAT BILALLI**-une e falenderoj Sokolin për ato që i tha po është nje e vertet se ne si subjekt politik ne zgjedhjet e fundit me vota kemi qen e treta ne komune,por qysh ne fillim është ber shkelje janë zgjedh në këtë komitet njerz të pamvarur në këtë rast përmendi Fatmir Dugollin, i cili ka kaluar në PDK e kjo ka qenë e paligjshme, sepse ministra ma ka kthyer pergjigjjen pozitive dhe ne kete rast i njoftoj më pergjigjje

**NAIM BAZAJ**-deklaroj se sipas kesaj shkrese Rifat Bilalli zëvëndesohet me Emri Lladrovcin dhe nuk kemi qka të diskutojm për këte qeshtje

**IDRIZ HYSENAJ**-ajo që ju po prezantoni nuk është e vertet, se zëvendsimi i anetarit ne rast të dorëheqjes ne kete rast vjen po nga i njejti subjekt që ka

qene anëtari i me hershem, kete pergjigjje e ka kthy edhe MAPL-ja ,opozita ka dy anetar në KPF-ca dhe as ligji nuk e lejon me pas me teper pasi që tash jemi 25 anëtar të Grupit parlamentar te PDK-së

**NAIM BAZAJ**-përseri deklaroj se MAPL-ja na e ka dhene kete pergjigje

**LIMAN KRASNIQI**-problemet jane kriju prej zgjedhjes se Fatmirit i cili është zgjedhur si i pamvarur, ndersa tash ka kaluar ne Grupin paralamentar të PDK-së

**XHAVIT DRENORI**-edhe MAPL-ja ka njerz të politikes dhe i perkrah ata as ata nuk jane duke e respektu ligjin

**KRYETARI I KOMUNËS-RAMIZ LLADROVCI**-dokumnetin që po e prezanton Kryesuesi nuk është dokument zyrtar ,është nje dokument që ka ardhur sot me I-mail i pa nënshkruar dhe i pa protokoluar ,dokument zyrtar është kërkesa e MAPL-së, ku shumë mir e specifikon se duhet të zevendesohet anëtari i komitetit që ka dhene dorëheqje po nga i njëjti subjekt që ai i ka takuar me rastin e dorëheqëjes

**NAIM BAZAJ**- i njoftoj anëtaret e kuvendit edhe për Ryshqyrtim të vendimit për emertim të rrugëve që kanë kërku harmonizimin e nje neni më ligjet ne fuqi dhe jemi të obliguar që ta dergojm në MAPL për te cilen gje u pajtuan anëetaret e kuvendit që ishin prezent

**NAIM BAZAJ**- kërkoj që të diskutojm edhe për nje pike të rendit të dites që na e ka sjell Kryetari

**KRYETARI I KOMUNËS - RAMIZ LLADROVCI** -kërkoj që të diskutojm dhe ta votojm propozim vendimin për ndertimin e shkollës profesionale në Komoran .

**LIMAN KRASNIQI**- lokacioni është shum i qelluar dhe është prone komunale ,por ka nga pak uzurpime dhe shpersoj që ato do ti zgjedhim dhe në këtë rast une e perkrahu këtë propozim vendim dhe kërkoj që të hidhet në votim

**FATMIR DUGOLLI**-gjithashtu e perkrahu këtë propozim vendim dhe kerkoj nga kryesuesi që te hidhet në votim

**NAIM BAZAJ** – hodhi në votim këtë pikë të rendit të dites

Me rastin e votimit prezent ishin 20 anëtarë

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për: 19

Kundër:0

Abstenim:01

**NAIM BAZAJ**- shpalli të mbyllur këtë seancë rreth orës 17 e 40 minuta

**Procesmbajtësi**      **Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Nebihi**      **Naim Bazaj**